



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave  
në Administrim Biznesi me profile “Sipërmarrja dhe  
Inovacioni” dhe “Marketing, Shitje dhe Komunikim”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**“Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Artur RIBAJ
2. Prof. Asoc. Dr. Jonida TETA

Dhjetor 2022



Dhjetor 2022

**Për programin e studimit të ciklit të parë Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile “Sipërmarrja dhe Inovacioni” dhe “Marketing, Shitje dhe Komunikim”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	“Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomisë (Fakulteti i Shkencave Ekonomike)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile “Sipërmarrja dhe Inovacioni” dhe “Marketing, Shitje dhe Komunikim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS nr. 275, datë 28.08.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS nr. 453, datë 25.07.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Ciklit Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip/anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (v.a 2021- 2022)	17PAE/3 PAK
18	Numri i studentëve:	183 studentë të rregjistruar
19	Komente / të tjera:	-



## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile: “Sipërmarrja dhe Inovacioni” dhe “Marketing, shitje dhe komunikim”, është një program i miratuar nga MAS për riorganizimin e tij bazuar në programin “Master Profesional në Administrim Biznesi” dy-vjeçar. Ky program ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë (DEK), pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike (FSHE) në UMSH.

Programi është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 275, datë 28.08.2020 dhe akreditohet për herë të parë. Programi i studimit “Master i Shkencave në Administrim Biznesi” me profile, ofrohet si gjuhë studimi edhe në gjuhën angleze me Urdhër të UMAS nr. 453, datë 25.07.2022, ky program studimi është në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe i përket nivelit 7 (shtatë) sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Programi ofrohet në gjuhën shqipe me kohë të plotë dhe është i organizuar në module të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit, gjithsej 120 ECTS i ndarë në dy vite akademike dhe katër semestra.

Objektivi kryesor i këtij programi është t’i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e administrim biznesit. Programi synon të formojë menaxherë dhe specialistë në fushën e marketing, shitje, komunikim, si edhe nxitjen e sipërmarrjes dhe inovacionit. Të regjistruar në vitin 2020-2021 ishin 220 studentë; në vitin 2021-2022 ishin 176 studentë.





## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**


Mbështetur në VKM nr. 109 ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit. Gjithashtu ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për akreditimin e programit Master Shkencor në “Administrim Biznesi” me profile. Grupi i jashtëm i vlerësimit përbëhet si më poshtë:

1. Prof. Dr. Artur Ribaj;
2. Prof. Asoc. Dr. Jonida Teta;
3. Msc. Arjana Alija, Koordinator teknik i ASCAL.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ky dokumentacion pati disa mangësi të cilat u kërkuar të plotësohen nga ekspertët para se ata të shkonin për vizitë.

Ekspertët përgatitën draft vlerësimit shoqëruar me pyetjet për pjesët që kërkonin qartësim të mëtejshëm dhe/ose verifikim të cilat u kryen gjatë vizitës në IAL në datat 16-17 Maj, 2022. Gjatë ditëve të vizitave në IAL u kryen diskutimeve intensive dhe proaktive mes GVJ dhe drejtuesve, pedagogëve, anëtarëve të GVB-së, studentëve, stafit administrative, etj. Dokumentacioni shtesë i kërkuar pas vizitës në IAL nga ekspertët u vu në dispozicion përmes sistemit AMS të ASCAL.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave dhe komenteve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master Shkencor në “Administrim Biznesi” me profile. Në fund do të paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.





Më datë 15/11/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 125/39 Prot., datë 16/11/2022, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 23/11/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 1876 Prot., datë 25/11/2022.

**PËRGJIGJE PËR KOMENTET MBI RAPORTIN E VLERËSIMIT TË JASHTËM  
NGA UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË**

**GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:**

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.6 Kriteri 2:**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse thuhet qartë që janë thjesht evidenca dhe të dhëna për këtë program studimi.

2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.1 Kriteri 5:**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse është e shkruar qartë se çfarë është kërkuar gjatë vizitës në këtë njësi dhe dokumentat nuk ju vendosën në dispozicion GVJ-së.

3. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.6 Kriteri 2 dhe 4:**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë ndryshon** duke e hequr nga fjalia pjesën “departament” dhe vendosur fjalen nga “Sekretaria mesimore”

4. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.6 Kriteri 7:**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë ndryshon** duke e hequr nga fjalia pjesën nga “Sekretaria mesimore” dhe vendosur *nëpërmjet sistemit SMS në kohë reale.*

5. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.1 Kriteri 1,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse tregon procesin e gjallë të adresimit të një gjetje nga GVJ, e cila u arritë të adresohet në kohë dhe kjo përcjell në raport procesin e përmirësimit të kryer në vijimin e vlerësimit. Për këtë arsye edhe vlerësimi për shkallën e përmbushjes së standardit është dhënë e plotë.

6. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.1 Kriteri 2,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse është e shkruar qartë se çfarë është kërkuar gjatë vizitës në këtë njësi dhe dokumentat nuk ju vendosën në dispozicion GVJ-së. Por duke konsideruar komentet e mëpasshme të përcjella nga strukturat



respektive, u gjykua nga GVJ të mos konsiderohet si gjetje për rekomandim, duke mos afektuar edhe vlerësimin për shkallën e përmbushjes së standardit.

7. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.1 Kriteri 3,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë ndryshon** duke e hequr nga fjalia pjesën “pa grada shkencore“, pavarësisht se ky konstatim i GVJ nuk kishte afektuar vlerësimin për shkallën e përmbushjes së standardit.

8. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.2 Kriteri 4,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** si konstatim i GVJ, pavarësisht se hiqet pjesa e paragrafit ku e ka cituar këtë edhe si rekomandim të BA.

9. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.3 Kriteri 1,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse GVJ e konstatoi si gjetje dhe përforsimi i saj vjen për më tepër kur është dhënë edhe më herët si rekomandim për plotësim sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.62, datë 18.12.2020 për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë.

10. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.4 Kriteri 4,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë ndryshon** duke e hequr fjalën “Questia“ dhe komentin për mungesën e të dhënave në lidhje me të drejtën e autorit për dixhitalizimin e teksteve pavarësisht se vetë IAL citon se ka dixhitalizuar rreth 17 000 tituj tekstesh mësimore nga fushat e programeve të studimit që ofron.

11. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.4 Kriteri 5,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse në evidencat e depozituara nuk gjendet një plan i detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet me këtë program studimi.

12. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.6 Kriteri 3,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse GVJ shprehet këtu në lidhje me atë çfarë i kërkohet nga kriteri përkatës dhe evidencat e depozituara nga IAL. Kriteri kërkon: “Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.“ Evidencat për vlerësimin e plotësimin të këtij kriteri munguan.

13. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.4 Kriteri 5,**



**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse konstatimi i dhënë në këtë pikë nga GVJ nuk kundërshtohet në narrativën e dhënë nga GVJ për standardin V.8, kriteri 1, ku përsëri evidentohet se: "...nuk është e qartë nëse ka një zyrë me staf të dedikuar vetëm për këto detyra apo krahas disa pozicioneve punësh të tjera ju duhet të kryejnë edhe këto detyra të cilat në fakt janë shumë të rëndësishme jo vetëm pse janë detyrim nga kuadri ligjor e rregullator..."

14. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.5 Kriteri 2,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** konstatimin e dhënë në këtë kriter nga GVJ, pavarësisht se për qartësim është kryer një riorganizim i fjalëve në fjali.

15. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.5 Kriteri 5,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** konstatimin e dhënë në këtë kriter nga GVJ, pavarësisht se është kryer zëvendësimi i fjalës "pretendohet" me fjalën "evidentohet".

16. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.6 Kriteri 3,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** pasi komentit dhënë nuk është relevant.

17. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.7 Kriteri 1,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon,** referoju përgjigjes së dhënë për komentin lidhur me Standardin V.4 Kriteri 5.

18. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.7 Kriteri 2,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** pasi komentit dhënë nuk është relevant.

19. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.7 Kriteri 6,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** pasi komentit dhënë nuk është relevant.

20. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.8 Kriteri 1-4,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** pasi komentit dhënë nuk është relevant.


21. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi VI.2 Kriteri 1-5,**



**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** me përjashtim të heqjes së një prej rekomandimeve “Stafi akademik me grada dhe tituj duhet të ketë kontrata pa afat.”, duke u besuar në “buona fide” për mos ekzistencën e kësaj gjetje të cilës i jemi referuar evidencave të vetë IAL-së: “...informacioni i përftuar nga këta instrumenta kontrolli pas përpunimit përdoret **në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog** në përfundim të vitit akademik nga ana e njësive përgjegjëse **para firmosjes së kontratës vjetore**”

22. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi VI.3, VI.4 dhe VI.5,**

**GVJ konkludon që Raporti në këto pika nuk ndryshon** sepse konstatimet e dhëna në këto pika nga GVJ nuk rezultojnë të plotësuara siç kërkohen në kriteret dhe standardet përkatëse. Për më tepër referojuni RVJ në paragrafet respektive dhe mirëkuptoni sugjerimet e dhëna me qëllim vijimin e përmirësimit të cilësisë për këtë program studimi.





**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile “Sipërmarrja dhe Inovacioni” dhe “Marketing, Shitje dhe Komunikim**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile: “Sipërmarrja dhe Inovacioni” dhe “Marketing, shitje dhe komunikim”, është një program i miratuar nga MAS për riorganizimin e tij. Ky program ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë (DEK), pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike (FSHE) në UMSH. Programi i studimit përmban lëndë dhe kurrikula të cilat janë në përputhje me interesat kombëtare. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu I, Neni 4</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri. Plani strategjik i Institucionit ( <i>Referenca E.1.1, pika “Misioni”, fq. 3</i> ) shpreh se “programet e studimit synojnë në konsolidimin e vlerave akademike kulturore e kombëtare” dhe është në përputhje me Statutin e UMSH. <i>Evidenca 2. Plani strategjik zhvillimit UMSH</i> <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile: “Sipërmarrja dhe Inovacioni” dhe “Marketing, shitje dhe komunikim” është mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM 41/2018 për elementët e studimit, në udhëzimet 15 dhe 31 të MAS, ( <i>E.6.4-Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i> ), në manualin e ASCAL për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin si edhe në Statutin dhe Rregulloren e UAMSH dhe në Rregulloren e Departamentit të Ekonomisë  Në këtë mënyrë programi i studimit i rregulluar nga kjo rregullore ofrohet në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë së tij të përcaktuara në statutin e tij. GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e UAMSH ku në qendër është studenti dhe kjo gjë u konstatua edhe gjatë takimeve me vetë studentët dhe stafin akademik, në ditët e vizitave në institucion.  <i>Evidenca 2. Plani strategjik zhvillimit UMSH</i> <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile</i>




<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentat bazë dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Ky program është mbështetur në strategjinë e zhvillimit të programit dhe përputhet me strukturën e ekonomisë shqiptare.</p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Ky program studimi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të UMSH, dhe të së drejtës për realizimin e studimeve të thelluara të ciklit të tretë nga Fakulteti i Ekonomisë në UMSH, programi i studimit MscAB jep mundësi në zhvillimin e njohurive shkencore në fushën e ekonomisë dhe menaxhimit në ciklin e trete të studimeve. Kjo tregohet edhe në zhvillimet më të fundit në UMSH, me miratimin dhe hapjen e aplikimeve për studime doktorale në fushën e ekonomisë</p> <p><i>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit UMSH</i> <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b> <b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se programi MScAB me profile, është në përputhshmëri të plotë me qëllimin dhe vizionin strategjik të zhvillimit të Institucionit dhe synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Strategjia e institucionit përcakton “ofrimin e programeve studimore në përputhje me nevojat e tregut të punës”, si dhe saktëson si prioritete “garantimin e përgatitjes cilësore dhe suksesit të studentëve, ekselencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor dhe pjesëmarrje intensive në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare” Strategjia e zhvillimit të këtij programi është në harmoni me Planin Strategjik të Zhvillimit të UMSH.</p> <p>Misioni dhe objektivat e programit të studimit janë në përputhje të</p>



	plotë me misionin e përgjithshëm dhe objektivat e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. <i>Evidenca 2. Plani strategjik izhivillimit UMSH</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Bazuar në analizën e dokumentave strategjikë të institucionit, Statuti, Plani Strategjik i Institucionit, Plani Strategjik i Departamentit, Rregullorja e Institucionit, Rregullorja e Departamentit, si edhe Rregullorja e programit të studimit dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në këto dokumenta. Pra ky program ndjek dhe zbaton misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu VIII, Neni 62 dhe 63</i> <i>Evidenca 2. Plani strategjik izhivillimit UMSH</i> <i>Evidenca 4. Rregullore e Organizimit UMSH, Kreu VI.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimit MScAB me profile, si në emërtim, organizim, strukturë dhe përmbajtje të tij, është në përputhje të plotë me fushat e drejtimit akademike të UMSH-së. Ky program me profil ekonomik është në përputhje me objektivat e FSHE si një nga shtyllat kryesore të UMSH. <i>Evidenca 2. Plani strategjik izhivillimit UMSH</i> <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Shqyrtimi i dokumentave bazë dhe vizita në institucion e GVJ, konfirmon se programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Programi i studimit MScAB me profile është konceptuar dhe formatuar duke pasur parasysh strategjitë kombëtare të zhvillimit ekonomik, social, politik dhe mjedisor. Programi, gjithashtu është bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare. <i>Evidenca 2. Plani strategjik izhivillimit UMSH</i> <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara	Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se programi i Studimit MScAB me profile, në planin strategjik, në rregulloren e tij, si dhe në syllabuset e ofruara, ka të përcaktuar qartësisht objektivat për formimin e studentëve, dijet, aftësitë dhe kompetencat





<p>shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ndër objektivat formues të programit përfshihen dijet, kompetencat dhe aftësitë që studentët e programit duhet të fitojnë në përfundim të tij dhe këto janë në përputhje me atë që kërkon tregu. Organizimi i aktivitetit mësimor, shkencor është në mënyrë të tillë që studentët të përfitojnë maksimalisht njohuri dhe kompetenca. Përbajtja e programit (syllabuset e lëndëve dhe moduleve), ka të përcaktuara qartë qëllimet, objektivat, dijet dhe kompetencat profesionale që studentët përfitojnë në përfundim të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile</i>  <i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile</i>  <i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruar për vitin akademik 2021-</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna të analizuara dhe konkluzione konkrete të një studimi të tregut në përgjithësi dhe programi i studimit MScAB është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Investimi në kapitalin njerëzor, duke e pajisur me kompetenca administrim biznesi në profilet sipërmarrja dhe inovacioni si dhe marketing, shitje dhe komunikim, është edhe qëllimi kryesor i këtij programi studimi.</p> <p>Studimi i tregut në aspektin metodik përfshin analizën e kërkesës dhe ofertës sipas metodologjisë europiane të studimit të tregut të punës, ku përfshihen tregues kombëtarë por dhe tregues të rajonit ballkanik. Në projektimin dhe realizimin e tij janë mbajtur parasysh: të dhënat e INSTAT mbi kërkesat e tregut për punësim, sipas profilit që ofrohet; kërkesat e punëdhënësve; të dhënat e MASR për fluksin e të diplomuarve në programet bachelor në IAL publike dhe jo publike që ndjekin studimet master, si dhe programet e ciklit të dytë që ofrohen.</p> <p>Në vijim studimi ka analizuar kërkesën duke marrë në konsideratë portalet e zyrave të punës, shoqatat e investitorëve, ndryshimet e tregut të punës, numrin e të rregjistruarave në IAL në këto profile dhe tregues të tjerë për të përlogaritur në mënyrë të përafërt numrin e studentëve që pas mbarimit të programit si dhe të studentëve alumni të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><i>Evidenca 7. Analiza e tregut të punës</i>  <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 21</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva formues të përcaktuar qartë që konsistojnë në rritjen e kapacitetit, të aftësive dhe të profesionalizmit të studentit që ose është i punësuar ose do të hyjë pas këtij programi në tregun e punës. Ky program mbështetet në njohuritë e përfituara në ciklin e parë të studimeve dhe garanton përfundimin e dijeve,</p>



<p>përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>aftësive, shkathtësive e kompetencave në përputhje me nevojat e tregut të punës. Programi synon formimin e shprehive të veçanta nëpërmjet lëndëve bazë, formuese, karakterizuese që synojnë pajisjen e studentëve jo vetëm me njohuri bazë shkencore dhe profesionale në fushën e menaxhimit, por edhe me shprehje të transferueshme dhe ndihmëse duke kontribuar në zgjerimin e mundësive për punësim në të dy profilet e programit.</p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021- 2022</i>  <i>Evidenca 7. Analiza e tregut të punës</i>  <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile:</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ gjatë takimeve me dekanin dhe përgjegjës të departamentit sikurse edhe në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, u evidentua se programi i studimit është bazuar në kurrikula të ngjashme të ofruara nga vendet e rajonit dhe BE. Bashkëpunimi ndërinstitucional midis UMSH dhe IAL homologe, ka bere te mundur përfrimin e programeve, duke mundësuar transferimin e studimeve në IAL të tjera, zhvillimin e lëndëve ose semestrave të plotë në universitete të vendeve të BE (në kuadrin e projekteve Erasmus+), si edhe punësimin e të diplomuarve nëse do të orientojnë kërkimin e tyre në tregun e huaj të punës. Për më tepër, programi mësimor i MScAB (profili MSHK) është pranuar për tu ekuivalentuar me programe të ngjashme në Universitetin e Tuscia, Itali duke i hapur rrugë lëshimit të diplomave të dyfishta për këtë program.</p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021- 2022</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvijën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar bazuar në legjislacionin shqiptar i cili është në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE. Programi është në përputhje me kërkesat e Bolonjës dhe suplementi i diplomës bazohet në modelin e hartuar nga Këshilli Europian.</p> <p><i>Evidenca 2. Plani strategjik zhvillimit UMSH</i>  <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Moduli “Praktika” zhvillohet në përfundim të lëndëve të tjera, në semestrin e dytë, përpara se studentët të realizojnë për mbrojtjen e diplomës. Programi mësimor i praktikës është ndërtuar në funksion të detyrave dhe kompetencave që i duhen studentit për të përshtatur dhe aplikuar dijet teorike në punën konkrete në kompani dhe institucione. Synimi i modulit është që studentët të thelojnë më tej dijet e njohuritë e fituara në procesin mësimor; të asistojnë e aktivizohen në veprimtarinë praktike të organizatave private ose publike në fushat përkatëse, si dhe të shtojnë aftësitë kërkimore shkencore në të dy profilet. Institucioni</p>






	<p>gjithashtu organizon dhe intensifikon marrëdhëniet me biznesin për të ofruar praktika edhe mundësi punësimi për studentët e programit, duke përmbushur edhe objektivat e programit. Kjo nisur edhe nga numri relativisht i lartë i studentëve që janë të punësuar në përputhje me diplomën</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile</i>  <i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruarapër vitin akademik2021-2022</i>  <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile:</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MScAB me profile organizohet në gjuhën shqipe dhe i orientuar në nivel kombëtar, por njëkohësisht është i hapur ndaj përvojave botërore. Në syllabuset e lëndëve përbërëse të këtij programi përcaktohet literaturë ku përfshihen tekste, artikuj dhe botime në gjuhë të huaj, të cilat janë të rekomandueshme për tu studjuar nga studentët, në përputhje me njohuritë e gjuhës së huaj që ata zotërojnë. GVJ gjatë takimeve konstatoi se njësitë përgjegjëse për programin po përgatiten për zhvillimin e disa lëndëve në gjuhën angleze duke filluar nga viti akademik 2022-2023.</p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruarapër vitin akademik2021-2022</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>GVJ gjatë takimeve konstatoj se në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, UMSH si në nivel institucional ashtu edhe në nivel programi, ka organizuar punën që njësitë përgjegjëse të përgatisin dhe ruajnë dokumentacionin për programin e studimit edhe në gjuhën angleze. Ky dokumentacion për programin MScAB me profile është në departament</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet në tërësi</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMSH ka në dispozicion burimet njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të tij. Stafit i Fakultetit është me përvojë dhe i kualifikuar (pjesa me e madhe), në fushat specifike që mbulojnë këtë program studimi. Nga shqyrtimi i dokumentave dhe vizita në Zyrën e burimeve njerëzore, sikurse dhe në takimet me stafin u vu re që rekrutimi i stafit të ri bëhet sipas kriterëve të mirëpërcaktuara dhe akteve nënligjore në fuqi.</p>




	<p>Referuar dokumentit <i>RVB si edhe Tabelës 1</i>. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Departamenti i Ekonomisë përgjegjës për këtë program, në bashkëpunim me fakultetet e tjera të UMSH, disponojnë burimet e nevojshme akademike për të realizuar këtë program studimi. Të dhënat për personelin akademik efektiv dhe me kontratë dhe plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës e demostrojnë këtë kapacitet. FSHE aktualisht ka në përbërjen e tij tre departamente, ku angazhohen gjithsej 69 anëtarë (personel akademik efektiv dhe me kontratë). Nga këta, personel akademik efektiv janë gjithsej 52 persona, me përvojë në mësimdhënie dhe punë kërkimore, të cilët bashkërendojnë aktivitetin dhe mbështesin kualifikimin edhe të pjesës tjetër të stafit të fakultetit.</p> <p><b>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 1; Tabela 2.</b></p> <p><b>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</b></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit që akreditohet është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Ekonomisë që është njësi bazë e ofrimit të tij. Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Si nivel studimi, ky program mban numrin 7 të kornizës evropiane (dhe shqiptare) të kualifikimit. Ai përkon me klasifikimin e fushave të arsimit, sipas ISCED-F 2013, klasifikim i cili perdoret nga MASR dhe INSTAT. Ky program perfshihet ne fushen 4 – Biznes, administrim dhe ligj.</p> <p>Përmbajtja e lëndëve në përbërje të programit të studimit garanton njohuri aftësi dhe kompetenca të nivelit 7 të AQF (Albanian Qualification Framework).</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile</b></p> <p><b>Evidenca 10. CV e stafit akademik të programit të studimit MScAB me profile</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Ekonomisë, si njësi bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit si edhe në përputhje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><b>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 9; Tabela 10;</b></p> <p><b>Evidenca 10. CV e stafit akademik të programit të studimit MScAB me profile</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>





<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit njësi baze përgjegjëse është Departamenti i Shkencave Ekonomike, me detyrën për të përmbushur qëllimin e programit. Realizimi i programit bazohet në aktet rregullatore të institucionit (statut, rregullore e fakultetit, rregullore e departamentit, rregullore e programit), të cilat garantojnë mbarëvajtjen dhe realizimin me cilësi të tij. Detyrat dhe kompetencat e secilës strukturë janë të përcaktuara qartë në këto akte rregullatore. DEK, si njësi përgjegjëse për organizimin dhe monitorimin e programit, garanton ecurinë e procesit mësimor, mbikëqyr personelin akademik dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit. Pjesë përbërëse e këtij monitorimi është dhe NJBSCZHK, e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme sigurimin e cilësisë në institucion.</p> <p>Kështu, departamenti merr masat që personeli akademik efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) të realizojnë orët mësimore sipas planit mësimor dhe kalendarit akademik, duke koordinuar me njësitë e tjera që të krijohen kushte optimale për realizimin e programit mësimor dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij. Në vecanti, zyra e IT siguron mbulimin audio-viziv në çdo auditor ku zhvillohen leksione, seminare, punë shkencore apo aktivitete të tjera të ngjashme, si dhe shërbim të pandërprerë të internetit (wifi). Cdo strukturë/njësi përgjegjëse ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit të studimit dhe informon drejtuesit respektivë.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile</i>  <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i>  <i>Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë,</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara nga IAL dhe takimeve me studentët si dhe stafin, GVJ konstatoi se UAMSH ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi, të cilat ndikojnë në realizimin e objektivave të programit të studimit</p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 5;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje</p>	<p>GVJ konstatoi se në planin mësimor të këtij program studimi praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm, dhe ka qëllim që studenti të zbatojë njohuritë teorike në praktikë, të ketë kontakte me tregun e punës</p>





<p>të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>etj. UAMSH ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi të cilat shfrytëzohen për praktikat profesionale të studentëve (Referenca Tabela 5)..</p> <p>Bazuar në dokumentacion por edhe në takimin me studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ndjekja dhe realizimi i praktikave të studentëve është i mirë organizuar dhe funksional.</p> <p>(referuar Marrëveshjeve të bashkëpunimit)</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Bashkëpunimi ndërmjet UAMSH dhe bizneseve për bërjen të mundur realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij program studimi, bëhej nëpërmjet marrëveshjeve por edhe me anë të kërkesave të vecanta. Gjithsesi u konstatua se institucioni/biznesi ku studentët kryejnë praktikën është e lidhur me fushën e studimit.</p> <p><i>Evidenca8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 5;</i></p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion institucioni, në funksion të mobilitetit të personelit dhe studentëve dhe realizimit të kërkimeve shkencore të tyre, ka përcaktuar bashkëpunimin si prioritet dhe në kuadër të zbatimit të strategjisë për bashkëpunim, ka vendosur marrëdhënie institucionale me universitete brenda dhe jashtë Shqipërisë, të cilat bëjnë pjesë në historikun e ngjarjeve shkencore të UMSH dhe dëshmojnë për një traditë të konsoliduar kërkimore dhe bashkëpunimi të gjithanshëm. Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet homologe është materializuar përmes mobilitetit të personelit dhe studentëve në universitetet në Poloni, Itali, Rumani që janë realizuar së fundmi dhe në Portugali e Itali që do realizohen në shtator 2022. Këto shkëmbime përfshijnë edhe punë kërkimore të përbashkët të stafit tonë me kolegët në universitet.</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Institucioni si edhe nga takimet që u organizuan gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi se Institucioni, Fakulteti si edhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi kryen analiza periodike të përfitimeve nga marrëveshjet. Këto vlerësime evidentohen vetëm në raportimet vjetore brenda institucionit.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="566 1545 730 1624"></th> <th data-bbox="730 1545 965 1624">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="965 1545 1193 1624">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1193 1545 1423 1624">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="566 1624 730 1668"></td> <td data-bbox="730 1624 965 1668"></td> <td data-bbox="965 1624 1193 1668"></td> <td data-bbox="1193 1624 1423 1668">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi I.6


**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------





<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave me fokus ngritjen profesionale të personelit, UMSH mbështet pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca shkencore që organizon vetë institucioni, në konferenca të tjera brenda dhe jashtë vendit, publikimin e punës së tyre kërkimore dhe mbështetje të tjera financiare</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Në UMSH Zyra e Kërkimit Shkencor është njësia përkatëse që merret me kërkimin shkencor i cili është i lidhur ngushtë me punën për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, me rritjen e nivelit të procesit e ndërkombëtarizimit të programeve të institucionit. Niveli i kërkimit shkencor vlerësohet periodikisht si në aspektin sasior ashtu dhe në atë cilësor.</p> <p><a href="https://www.umsh.edu.al/c/129/botime-umsh-press">https://www.umsh.edu.al/c/129/botime-umsh-press</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave GVJ konstatoi se institucioni ndjek një politikë të kujdeshme të promovimit të botimeve të tij duke bashkëpunuar edhe me institucione të tjera. Në tre vitet e fundit nga pedagogët e këtij institucioni janë botuar 3 monografi në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave, një monografi të botuar në gjuhën angleze, dhe shumë botime në revista ndërkombëtare me faktor impakti. Të gjitha keto kanë rritur ndjeshëm promovimin e kulturës kërkimore në nivel rajonal dhe kombëtar. Nje tregues i promovimit të punës kërkimore shkencore te institucionit është dhe fakti se shumë botime të pedagogeve janë prezentë në tregun rajonal por edhe atë perëndimor</p> <p><a href="https://www.umsh.edu.al/media/5f7199578a12e.pdf">https://www.umsh.edu.al/media/5f7199578a12e.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Ruajtja e pronësisë intelektuale realizohet nëpërmjet vleresimit objektiv të veprimtarisë botuese edhe mbi të gjitha tek stimulimi i punës së studentëve dhe ruajtja e saj. Ky fakt ka bërë që të promovohen dhe të zhvillohen të drejtat e bashkeautoresisë. Deklaratat e autorësisë në punimet e studenteve (tema e diplomës) dhe bashkëpunimet midis brezave të personelit të institucionit janë mundesi e mirë e ruajtjes së pasurisë intelektuale</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Njohuritë bazë dhe të përdorshme që marrin studentët gjatë këtij program studimi kanë për qëllim jo vetëm orientimin e tyre drejt tregut të punës por dhe në iniciativat e tyre sipërmarrëse. Rritja e bashkëpunimeve me universitetet e huaja për aplikime të përbashkëta, rritjen e pjesëmarrjes së pedagogëve në këto projekte dhe angazhimi gjithnjë dhe me i madh i studenteve në këtë fushë synon realizimin e këtij objekti.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Jo përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p><b>X</b></p>





Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit përmban lëndë sipas ligjit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë</li> <li>- Lëndë karakterizuese</li> <li>- Lëndë ndërdisiplinore dhe Lëndë integruese;</li> <li>- Lëndë plotësuese</li> <li>- Detyrime përmbyllëse</li> </ul> <p>UMSH ofron programe të studimeve të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor për programin e studimit MScAB pasqyron zhvillimin e programit në dy vite akademike, me 120 kredite, sipas përcaktimeve për programet master i shkencave në legjislacionin për arsimin e lartë. Plani përmban informacionet për lëndët/module të vlerësuara me kredite sipas sistemit ECTS si dhe siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore ndërmjet semestrave (gjithsej katër semestra me nga 15 javë secili).</p> <p>Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me ECTS dhe në kategoritë sipas ligjit dhe në përfundim të studimeve studentët përfitojnë 120 ECTS.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti UMSH, neni 63</i></p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit MScAB ofron njohuri të thelluara profesionale në fushat ekonomike dhe kryesisht atë të Administrimit të Biznesit i ndarë në dy profile të ngjashme por jo-identike, siç janë profili “Marketing, Shitje dhe Komunikim” dhe profili “Sipërmarrja dhe Inovacioni”. Secili profil ka si qëllim përgatitjen e drejtuesve, specialistëve apo pjesëtarëve të stafëve të kompanive private, të institucioneve shtetërore apo organizatave</p>



	<p>jofitimprurëse me një orientim të caktuar.</p> <p>Përfundimi me sukses i këtij programi studimi u mundëson studentëve rritjen e shanseve për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre profesionale apo akademike shkencore.</p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teoriave dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në programin e studimit MScAB jepen njohuri të thelluara nga fusha e menaxhimit, marketingut, menaxhimit të shitjeve, sjelljes konsumatore dhe teknologjisë së informacionit si dhe u mundëson studenteve pajisjen me dije dhe aftësi për të analizuar situata dhe për të zgjidhur probleme nëpërmjet vendimmarrjeve racionale Programi ka evidentuar për çdo specialitet elementët e nevojshëm teorikë të përdorshëm në praktikë. Kjo evidentohet në syllabuset e secilës prej lëndëve të programit.</p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Në programin e studimit MScAB përfshin module që zhvillojnë njohuritë e studentëve në fushën profesionale të menaxhimit marketingut, menaxhimit të shitjeve, sjelljes konsumatore dhe teknologjisë së informacionit. Ky program studimi ka për qëllim të pajisë me njohuri teorike dhe praktike të diplomuarit në këtë program studimi. Gjithashtu objektivi kryesor i këtij programi është të japë njohuri mbi mekanizmat dhe marrëdhëniet financiare si edhe të pajisë studentët me aftësinë menaxheriale si edhe me kompetenca argumentuese dhe këshilluese për institucione të ndryshme në fushën e ekonomisë. Gjithashtu ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e administrimit të biznesit dhe sipërmarrjes</p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit sic është përcaktuar nga ligji, duke përcaktuar strukturën e krediteve, orët në auditor, orët jashtë auditorit, studimin e pavarur, sipas viteve dhe semestrave.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit me profile ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe përmban veprimtaritë formuese të grupuar sipas kategorive të ligjit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Lëndë bazë: (11 kredite)</b></li> <li>2. <b>Lëndë karakterizuese: (59 kredite)</b></li> <li>3. <b>Lëndë ndërdisiplinore: (22 kredite)</b></li> <li>4. <b>Lëndë plotësuese: (10 kredite)</b></li> <li>5. <b>Detyrime përmblyese: (18 kredite)</b></li> </ol>




	Sa më sipër janë konform ligjit në fuqi. (Referenca Tabelat përmbledhëse: tabela 9)			
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	GVJ konstaton se në planin mësimor të programit për diplomën janë parashikuar 18 kredite, pesha në kredite është në përputhje me VKM nr 41.  <i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021- 2022</i> <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 9</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë i cili i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Si njësi kryesore bashkërendon veprimtarinë mësimore- shkencore në fushën e ekonomisë. Departamenti i Ekonomisë zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor.  <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 3 Të dhëna Tabelore për numrin e programeve të studimeve që ofrohen në njësinë përgjegjëse</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Shkencave Ekonomike (FSHE) organizohet në tre njësi bazë, përkatësisht: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti Financë, Bankë dhe Kontabilitetit,</li> <li>• Departamenti i Ekonomisë,</li> <li>• Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor.</li> </ul> Veprimtaria e fakultetit dhe e secilit prej departamenteve të FSHE realizohet duke u mbështetur në aktet rregullative të UMSH (Statuti, Rregullorja e Organizimit të UMSH) dhe në rregulloret e njësive përkatëse, në të cilat pasqyrohen misioni dhe objektivat e secilës prej tyre.  Departamenti i Ekonomisë, përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, organizohet në dy grupe mësimore-kërkimore. Kjo njësi bazë programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore në disiplinat e ekonomiksit, menaxhimit, marketingut, sipërmarrjes dhe disiplina e lëndë të tjera të ndërlidhura të fushës ekonomike.



	<p><i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike si dhe Departamenti i Ekonomisë, përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, plotësojnë dhe tejkalojnë kriterin ligjor të përbërjes sipas numrit dhe gradave. Departamenti i Ekonomisë ka në përbërjen e tij 19 punonjës efektivë, prej tyre 12 me grada dhe tituj. Njëkohësisht 2 anëtarë të tij janë në proces të studimeve doktorale. Departamenti angazhon aktualisht në procesin mësimor dhe të kërkimit edhe 4 punonjës me kontratë, nga të cilët dy të kategorisë profesor, duke përfituar nga ekspertiza shkencore dhe përvoja akademike e tyre</p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Veprimtaria e Fakultetit dhe e secilit prej Departamenteve të FSHE realizohet duke u mbështetur në aktet rregullative të UMSH (Statuti, Rregullorja e Organizimit të UMSH) dhe në rregulloret e njësive përkatëse, në të cilat pasqyrohen misioni dhe objektivat e secilës prej tyre.</p> <p>Departamenti i Ekonomisë, përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, organizohet në dy grupe mësimore-kërkimore. Kjo njësi bazë programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore në disiplinat e ekonomiksit, menaxhimit, marketingut, sipërmarrjes dhe disiplina e lëndë të tjera të ndërlidhura të fushës ekonomike.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (<i>Referenca- Tabelat përmbledhëse: tabela 8</i>), Departamenti i Ekonomisë në vitin akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij gjithsej 23 pedagogë nga ku 19 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE), dhe 4 pedagogë me kontratë (PAK).</p> <p>Drejtohet nga një përgjegjës që zgjidhet me zgjedhje të lira dhe ka personel të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë për ofrimin e programeve. Departamenti i Ekonomisë, ka 19 personel akademik efektiv, nga të cilët me titull akademik: 1 Profesor Doktor, 3 Profesor i Asociuar dhe 8 Doktor ndërsa 5 janë me Master.</p> <p>Nga të dhënat, GVJ eidenton që stafi akademik PAE përgjegjës për këtë program studimi, është më i madh se stafi akademik PAK i angazhuar në këtë departament (19 PAE / 4 PAK).</p> <p><i>Evidenca 8: tabela 1 dhe 2</i></p> <p><i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi kërkon angazhimin e personelit për mbikqyrjen e praktikave të studentëve. Njësitë përgjegjëse për programin FSHE/DEK kanë personel të mjaftueshëm që angazhohet për ndjekjen e tyre.</p>






<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në zbatim të akteve rregullore dhe me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë ndërdepartamentale për programet master, FSHE ka caktuar një koordinator si përfaqësues në zyrën master kujdeset për realizimin e misionit dhe veprimtarinë e gjithanshme të këtyre programeve, sipas përcaktimit të detyrave të tij/saj në rregulloren FSHE dhe në kontratën e punës individuale.</p> <p><i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, neni 2</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike të drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Koordinatori i programit master angazhohet dhe bashkëpunon me njësinë bazë për të bashkërenduar shpërndarjen e ngarkesës së personelit akademik sipas lëndëve dhe programeve. Bashkë me njësinë bazë, koordinatori i programit master i propozon Dekanit të fakultetit orarin e mësimëve, kalendarin e provimeve, komisionet e pranimit të studentëve dhe organizon punën për pranimin e tyre në bazë të kriterëve të shpallura.</p> <p>Koordinatori i programit master mbikqyr dhe raporton tek Dekani mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të diplomimit në programin MScAB.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile, neni 7</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.3</b></p>	
<p><b>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se për programin MScAB, njësia kryesore dhe ajo bazë disponon të gjithë dokumentacionin lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit ku përfshihen, statuti i UMSH, rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit, rregullorja e programit mesimor, plani strategjik për zhvillimin e programit, plani mësimor, syllabet lëndore etj.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile</i></p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021- 2022</i></p> <p><i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, neni 20</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë</p>	<p>Organizimi i programit të studimit MScAB gjendet i pasqyruar në planin mësimor ku përfshihen informacionet për lëndet/modulet,</p>



<p>e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>praktikë profesionale, diploma, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian (ECTS). Ato janë të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese përcaktuar nga aktet ligjore në fuqi (aktualisht VKM nr. 41, 24.01.2018). <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile, Tabela 9;Tabela 10.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit MP MScAB përmban lëndë sipas ligjit: bazë-2, karakterizuese-5, ndërdisiplinore dhe integruese-3, plotësuese-1 dhe detyrime përmbyllëse-1. Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me ECTS dhe në kategoritë sipas ligjit dhe në përfundim të studimeve studenti përfiton 120ECTS.</p> <p>Veprimtaritë formuese të programit janë të formimit të përgjithshëm, karakterizues, ndërdisiplinore ose/dhe integruese dhe lende me zgjedhje (gjithsej 92 ECTS), praktikë profesionale (10 ECTS) dhe detyrime përmbyllëse- Teza e diplomës (18 ECTS). <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 9.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Mënyra e organizimit të programit të studimit MScAB pasqyrohet në planin mësimor përmes informacionit të detajuar mbi veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit, mbi komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: orë në auditor, (leksione 450 orë, seminare 388 orë, ushtrime/laborator 17 orë, praktikë profesionale 240 orë, diploma 50 orë), dheorë për studim individual/jashtë auditorit, si dhe mbi format e kontrollit të dijeve, që në këtë program përgjithësisht janë me provime.</p> <p>Skema e vlerësimit është e njëjtë në të gjitha lëndët. Mënyra e vlerësimit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi i ndërmjetëm (20%)</li> <li>• Provimi përfundimtar (60%)</li> <li>• Detyrat e kursit/prezantim/punë në grup (10%)</li> <li>• Pjesëmarrja aktive në seminar (10%)</li> </ul> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 13.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe</p>	<p>Programi i studimit ka rregulloren e vet ku përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm për studentët në lidhje me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve në nenet 10-13. Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore te</p>





specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>institucionit, përfshirë rregulloren e programit të studimit MScAB dhe shpallen në të gjitha mjetet e informimit të institucionit. Procedurat e pranimit të studentëve të rinj realizohen nga një komision i veçantë pedagogësh duke marrë parasysh vit pas viti kriteret bazë të vendosura nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe kriteret e veçanta që vendos vetë institucioni.</p> <p>Programi është i organizuar në mënyrë që të lejojë transferim të studimeve nga/në programe të tjera, duke bërë ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të UMSH dhe shprehet e përmbledhur në një udhëzues të posaçëm.</p> <p><i>Evidenca 14. Broshura e studimeve Master</i></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>GVJ nga shqyrtimi i syllabuseve, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për format e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar.</p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021- 2022;</i></p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB</i></p>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	<p>Nga intervista GVJ konstatoi se programi lëndor (syllabet) diskutohen në fillim të çdo viti akademik dhe dokumentacioni firmoset nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi respekton përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore (aktualisht VKM 41/ 2018) dhe përfshin orë mësimore në auditor për leksione, seminare, ushtrime/ laborator, praktikë profesionale, diploma/ provimi i formimit (jo më shumë se 25 orë në javë, gjithsej 1145 orë në të dy vitet) dhe orë për punë të pavarur





	<p>(jashtë auditorit) jo më pak se gjysma e fondit prej 1500 orë vjetore (1855 orë në të dy vitet). Programi është në përputhje me ligjet në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive ka një ndërthurje dhe kombinim të lëndëve që zhvillohen në të katër semestrat, duke i përshtatur jo vetëm me njohuritë që studentët duhet të marrin për këtë program studimi por dhe me kërkesat e tregut në mënyrë që studentët të mund të fillojnë një karrierë profesionale apo akademike shkencore të suksesshme. Praktika profesionale dhe përgatitja e tezës së diplomës, me të cilën përmbillen studimet, luajnë rol thelbësor në këtë drejtim. Kjo evidentohet në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve të programit.</p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021- 2022</i></p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile, Tabela 10.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Sipas planit mësimor të programit është përcaktuar se shpërndarja e moduleve në semestrin e parë dhe të dytë i jep studentëve njohuri bazë në fushën e administrimit të biznesit, të nevojshme për funksionet drejtuese që ata pritet të realizojnë në vendet e tyre të punës. Keto njohuri ndiqen në semestrin pasardhës nga lëndë të profileve përkatëse, sipas fushave respektive si dhe përmbillet me realizimin e praktikës dhe tezen e diplomes. Vlerësimi i lëndëve në kredite e mundëson arritjen e objektivave të programit.</p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit me të gjitha elementët që e shoqërojnë janë në përputhje me profilin e programit. Në lidhje me programet e tjera ndërkombëtare GVJ mendon se përafrimi ndërkombëtar duhet të jetë në fillim gjeografik rajonal në Ballkan dhe Europë, gjë të cilën e konfirmon në këtë rast.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese ndjek kërkesat ligjore, GVJ evidenton se raporti teori praktikë favorizon më tepër teorinë në mënyrë që të arrihen objektivat e programit por edhe në funksion të punësimin.</p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021- 2022</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabet e lëndëve ndjekin procesin e përditësimit çdo vit akademik, fakt i konfirmuar nga stafi i Departamentit dhe nga përgjegjësi i saj. GVJ në rishikim të dokumentacionit vëren se syllabet lëndore kanë</p>



	<p>të përditësuar literaturën e tyre sipas kërkesave ligjore në lidhje me 5 vitet e fundit.</p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021- 2022</i></p>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	<p>GVJ gjykon nga përmbajtja e programeve të lëndëve se për këtë nivel studimi të ciklit të dytë se lëndët janë me tematikat dhe koncepte bazë perkatese</p>			
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Duke marrë parasysh dhe sa janë përmendur në kriteret e mësipërme, GVJ gjykon se ky program ofron njohuri, aftësi dhe kompetenca të thelluara teorike dhe profesionale. Në programin e studimit MScAB formimi teorik dhe kryesisht ai praktik i studentëve bëhet në fushën e strategjive të marketingut, menaxhimit strategjik; menaxhimit të sistemeve të informacionit në fushat perkatese; lidhshimit; strategjive ne biznes; inovacionit dhe gjenerimit te aktiviteteve te reja. Ky formim mbështetet dhe ngrihet mbi njohuritë e fituara në programin e ciklit të parë. Hapja e studimeve doktrale në Shkenca Ekonomike pranë UMSH në vitin 2022 është një mundësi për thellim të studimeve dhe karrierën e tyre në akademike</p>			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	<p>GVJ gjykon se përmbajtja e programit e mundëson ecurinë e studentëve në studime të mëtejshme si edhe duke u bazuar te studimi i tregut te punes një pjesë e mirë e studenteve jane punesuar, cka bën të vlerësohet se ka një përqindje të lartë përshtatje me pritshmeritë e tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca 7. Analiza e tregut të punës</i> <i>Evidenca16. Dokument mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset.</i></p>			
<b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	<p>Në planin mesimor të programit studimit MScAB gjenden të pasqyruara lëndë qe kane si qellim ofrimin e njohurive si dhe aftësimin e studentëve ne fushën e kërkimit shkencor. Konkretisht ne lëndët Metodave të kërkimit në biznes, metoda sasiore, modelime dhe simulime në biznes studentëve u ofrohen njohuri sa i perket fazave të kerkimit shkencor, metodave te kerkimit/ modele e teknika te analizimit te te dhenave statistikore si dhe nje analize te detajuar te kerkimit sipas profileve te programit.</p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<p><b>Standardi II.5</b></p> <p><b>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me</b></p>				



**fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik i përmbush kërkesat ligjore në fuqi; pedagogët që mbulojnë nevojat e programit janë me titull Prof.Dr, Prof. Asoc, Dr, Dr në proces por edhe me titullin Msc por me ekspertizë dhe eksperiencë pune në fushën përkate të mësimdhënies.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (<i>Referenca-Tabelat përmbledhëse: tabela 8</i>), ky program studimi në vitin akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij gjithsej 23 pedagogë nga ku 19 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE), dhe 4 pedagogë me kontratë (PAK).</p> <p>Drejtohet nga një përgjegjës që zgjidhet me zgjedhje të lira dhe ka personel të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë për ofrimin e programeve. Departamenti i Ekonomise, ka 19 personel akademik efektiv, nga të cilët me titull akademik: 1 Profesor Doktor, 3 Profesor i Asociuar dhe 8 Doktor ndërsa 5 janë me master. Nga të dhënat, GVJ evidenton që stafi akademik PAE përgjegjës për këtë program studimi, është më i madh se stafi akademik PAK i angazhuar në këtë departament (19 PAE / 4 PAK).</p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 12;</i>  <i>Evidenca 10. CV e stafit akademik të programit të studimit MScAB me profile.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi mbulohet me staf akademik efektiv dhe staf akademik me kontratë.</p> <p><i>GVJ nga të dhënat e vëna në dispozicion, evidenton një tendencë në ngritje për mbulimin e programit në përqindje nga stafi akademik efektiv. Për vitin akademik 2021-2022 mbulimi i programit përmbush raportin 75% PAE / 25 % PAK.</i></p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 6; 7, 8.</i>  <i>Evidenca 10. CV e stafit akademik të programit të studimit MSc</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në Institucion, GVJ konstatoi se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> <p><i>Evidenca 10. CV e stafit akademik të programit të studimit MSc</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,</p>	<p>Sipas vizitës në institucion dhe marrëveshjeve në fuqi si dhe nga takimi me studentët, UMSH ofron mundësinë për të udhëzuar studentët në praktikën e tyre profesionale. Duke qenë se një pjesë e</p>





udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	studentëve janë të punësuar, në pjesën më të madhe institucioni ofron mbështetje në lidhje me temën e diplomës.  Në dokumentacionin e paraqitur nga insticioni përshkruhen me hollësi procedurat e zhvillimit të praktikës si dhe udhëzimet për punimin e diplomës.								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	UMSH ka kapacitete njerëzore dhe financiare për të garantuar mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, që janë në funksion të programeve të studimit, përfshirë edhe programin e studimit MScAB me profile								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


<b>Standardi II.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nga takimet që GVJ pati në Institucion ka patur rishikim të kurrikulës dhe në të janë përfshirë propozime nga aktorë nga biznesi apo aktorë të tjerë të tregut të punës. Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private i kanë mundësuar UMSH të mbajë kontakte dhe të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për njohuri, kompetenca, profesione dhe vende pune që krijohen dhe ndryshojnë herë pas here. Këto informacione fakulteti dhe departamenti i merr në takimet dhe aktivitetet e përbashkëta me partnerë nga tregu i punës: kompani, organizata dhe njësi të pushtetit qendror e lokal ku zhvillohen praktikat, lektorë të ftuar, anëtare të bordeve të punës etj. <i>Evidenca 7. Analiza e tregut të punës</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Nëpërmjet NJSBC institucioni ka filluar procesin e përfshirjes së studentëve në përmirësimin e programeve. Kjo kryhet nëpërmjet pyetësoreve që Drejtoria ka hartuar dhe analizon. Gjithsesi është akoma në fazë primare për të përcaktuar nëse reflektimi i propozimeve të studentëve në lidhje me programin e studimit është kryer për shkak të evidencave të pa mjaftueshme në lidhje me këtë.





<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka kryer një studim për tregun pas diplomimit, iniciativë të cilën GVJ e konsideron shumë të vlefshme në lidhje me vendimet strategjike në lidhje me programin por edhe me koordinimin administrativ të tij.</p> <p>Paralelisht Zyra e ALUMNI dhe Këshillimit të Karrierës e krijuar ne Universitet ka ndërmarë një nisëm për gjurmimin e studentëve të diplomuar në mënyrë që të krijohet një databazë me këta studentë. GVJ njih përpjekjen e institucionit për të përmbushur këtë kriter.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>UMSH ka kapacitete didaktike, infrastrukurore dhe menaxheriale që ti përgjigjet kërkesave dhe nevojave për programe specifike që mund të vijnë nga institucionet publike e private në nivel qëndror e lokal, në fushat e ekspertizës që mbulon edhe ky program.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.7</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit MScAB, janë në përputhje të plotë me drejtimit që institucioni ofron programet e studimit, me fushën e ekspertizës së personelit akademik të FSHE dhe me gjithë veprimtarinë kërkimore të njësisë që e ofron atë. Misioni dhe objektivat e programit të studimit MScAB janë të përshtatur me misionin e përgjithshëm të institucionit dhe shprehin qartë filozofinë e tij.</p> <p><i>Evidenca 2. Plani strategjik izhfillimit UMSH</i>  <i>Evidenca 3.Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile</i>  <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave ekonomike. Në këtë kuadër, departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët</p>	<p>Programi i studimit MScAB është rezultat i bashkëpunimit me universitete europiane dhe rajonale dhe zbatimit të politikave</p>





të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	studimore dhe shkencore europiane. UMSH është aktivisht e angazhuar për kualifikimin e mëtejshëm profesional të punonjësve të tij që kryesisht lidhet me mobilitetin e stafit akademik, shpërndarjen e informacioneve shkencore, mbështetjen për pjesëmarrje në konferenca e seminare kombëtare dhe rajonale, si dhe përfshirjen në studime konkrete. Kjo ben qe dhe studentet te jene pjese aktive e ketyre aktiviteteve.		
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Programi i studimit MScAB është rezultat i bashkëpunimit me universitete europiane dhe rajonale dhe zbatimit të politikave studimore dhe shkencore europiane. Kjo pasi UMSH është aktivisht e angazhuar për kualifikimin e mëtejshëm profesional të punonjësve të tij që kryesisht lidhet me mobilitetin e stafit akademik, shpërndarjen e informacioneve shkencore, mbështetjen për pjesëmarrje në konferenca e seminare kombëtare dhe rajonale, si dhe përfshirjen në studime konkrete.		
<b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Me fokus ngritjen profesionale të personelit akademik institucioni mbështet pjesëmarrjen në keto aktivitete. UMSH inkurajon dhe mbështet financiarisht pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet financimit të teksteve universitare dhe të tjera, financimit për botime artikujsh dhe konferencash si dhe nëpërmjet organizimit të konferencave ndërkombëtare nga UMSH pa pagesë. Në nivel institucional kërkimi shkencor mbështetet financiarisht nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ose nëpërmjet alokimit vjetor për kërkimin shkencor i cili inkurajon hulumtimin dhe publikimin në revista prestigjioze		
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi II.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Fushat themelore të kërkimit shkencor janë parashikuar në strategjinë e kërkimit shkencor dhe kanë si bazë Strategjinë Kombëtare të Kerkimit Shkencor. Ato janë fokusuar në specialitetet që ka vete UMSH dhe që janë ato të fushës ekonomike dhe menaxheriale. UMSH mundëson një mjedis motivues të kërkimit shkencor për personelin akademik dhe studentët, duke krijuar grupe pune dhe fusha kërkimore, si dhe nëpërmjet zyrës së projekteve bashkëpunon me



	institucione partnere në projekte shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Projekti doktorat në fushën e shkencave ekonomike			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Strategjia e zhvillimit e UMSH është proaktive, konkurruese dhe në partneritet me komunitetin duke ofruar shërbime në fushat respektive të ekspertizës. UMSH inkurajon dhe angazhon stafin akademik në veprimtari kërkimore shkencore dhe projekte dhe analiza studimore me impakt komunitetin. Tematika e diplomave të propozuara për studentët e programit MScAB dëshmon këtë orientim dhe angazhim të departamentit.			
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arrijtjen e objektivave	Informacionet shkencore në Departament janë një traditë në FSHE ku gjatë prezantimeve të ndryshme që behen nga personeli akademik, ftohen të marrin pjesë edhe studentët për të qenë sa më pranë të reja me të fundit të pedagogëve të tyre. Gjatë periudhave të ndryshme dhe sipas kontekstit, gjatë viteve të fundit, në auditoret e UMSH janë mbajtur leksione të hapura për studentët dhe webinarë të ndryshme për tema me interes për ta (gjatë vitit 2021-2022 nga specialistë të INSTAT, lektorë nga Universiteti Jagellonian Krakow, Poloni, etj.)  <i><a href="https://www.umsh.edu.al/d/311/perfaqesuesit-e-ambasades-greke-leksion-te-hapur-ne-umsh">https://www.umsh.edu.al/d/311/perfaqesuesit-e-ambasades-greke-leksion-te-hapur-ne-umsh</a></i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	GVJ konstatoi se UMSH nxit metodave interaktive dhe inovative të mësimdhënies. Stafi akademik është pjesë e marrëveshjeve të mobilitetit të cilat janë zbatuar edhe për stafin e fakultetit me synim rritjen profesionale të tyre nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me institucionet e huaja. Për më tepër ngritja e komisioneve të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe rregullorja e NJSBC monitoron rritjen e





	<p>cilësisë në mësimdhënie. Nga takimi me stafin akademik dhe me studentet, GVJ konstatoi se përdorimi i metodave interaktive përfshinte ushtrime praktike të kontabilitetit, balance apo case study nga realiteti për t'i bërë modulet sa më praktike.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Departamenti ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik.</p> <p>Nuk rezulton që të perdoren vlerësime të diferencuara midis pedagogësh dhe që synojnë stimulimin dhe inkurajimin e pedagogëve që aplikojnë metoda të reja dhe bashkëkohore.</p> <p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës në bashkërendim me NJSBC nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuar nga studentët. Vlerësimi i performancës kryhet në fund të cdo viti akademik, ndërsa pyetësori me studentët realizohet para provimeve dhe rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Gjithashtu NJSBC zhvillon edhe grup fokus të studentëve me pjesëmarrje të një numri të vogël studentësh për cdo program studimi dhe që zgjidhen në mënyrë rastësore. Mendimet dhe sygjerimet e marra nga këto grupe fokusi, NJSBC ja vë në dispozicion përgjegjësit të departamentit përkatës, i cili edhe jep përgjigje për marrjen në konsideratë apo apo vënien në zbatim të sygjerimeve</p> <p>Vlerësimi i stafit akademik gjithashtu bëhet për cdo akademik nga përgjegjësi i departamentit</p> <p><i>Evidenca 19. Plan pune i FSHE për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2021-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Departamenti dhe fakulteti organizojnë rregullisht metoda të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e formave, metodave dhe nivelit të mësimdhënies. Forma më e përdorur për këtë ka qënë organizimi i anketave dhe pyetësorëve, të cilët përpilohen në bashkëpunim me zyrën e kontrollit të cilësisë. GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësorëve, si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakëkanqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit</p> <p>Sipas konstatimit të GVJ rezultatet e pyetësorëve bëheshin të ditura për departamentin nga NJSBC për cdo semestër.</p> <p><i>Evidenca 20. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</p>	<p>Zyra përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë që është ngritur dhe funksionon në nivel universiteti, harton raporte dhe i bën</p>





në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	ato objekt diskutimi dhe analiza në senatin akademik. Gjithashtu për departamentin përgjegjës për këtë program studimi janë caktuar 2 pedagogë të cilët ndjekin çështjet e cilësisë në nivel departamenti. Paralelisht njësia bazë dhe kryesore (Departamenti dhe Fakulteti) bëjnë publike rezultatet në analizën vjetore të njësisë. Këto rezultate fillimisht diskutohen në një mbledhje të hapur departamenti. Vetëm pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat.		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion evidentohet se Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi përdorin mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Pyetëtori i studentëve përdoret si mjet për të evidentuar dhe vlerësuar shembuj të mirë dhe efikas në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rastet e specifikuar si pozitive nga studentët bëhen të ditura në mbledhjet e departamentit, sic na është konfirmuar edhe në takimet me përgjegjësen e Departamentit. Por në analizat vjetore të programit apo të procesit të mësimdhënies së Departamentit të Ekonomise që mbulon këtë program, nuk ka të dokumentuar raste të diferencuara, shembuj të praktikave të mira apo emra pedagogësh apo lëndësh që duhen promovuar dhe inkurajuar, që janë të mirëvlerësuar dhe që janë për këtë shkak të diferencuar nga pjesa tjetër e stafit		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në lëndët dhe modulet e këtij program studimi përdoren format klasike të mësimdhënies, të gërshetuara midis tyre, si leksionet, seminarët, ushtrimet, punimet e kursit, punët e pavarura, praktikë profesionale, tema diplome. Në procesin mësimor janë aplikuar edhe ftesa për personal akademik të jashtëm apo për personalitete të fushës të cilët kanë ofruar leksione të hapura dhe kanë sjellë në auditor eksperiencat e tyre apo të institucionave që kanë drejtuar
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e	Bazuar në informacionet e grumbulluara në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit, në lëndë të ndryshme, stafi akademik aplikon metoda të ndryshme të zhvillimit të procesit mësimor, në funksion të natyrës dhe vecorive së cdo lënde dhe të bazës materiale të nevojshme.  Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve janë të paraqitura në syllabuset dhe programet e lëndëve e moduleve Format



<p>studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>e mësimin teorik e praktik janë: leksionet dhe seminarët të integruara, ushtrimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit/projektet e kursit, etj. Format e kontrollit të dijeve janë testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit. Gjithashtu në UAMSH organizohen leksione të hapura nga lektorë të ftuar. Gjithashtu Institucioni i kushton vëmendje dhe rëndësi organizimit të konferencës studentore. Staf i është i hapur për përmirësimin dhe pasurimin e metodave të mësimdhënies ndër vite.</p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Ne kuadrin e mbështetjes të procesit të mësimdhënies, stafi akademik, ka mundësi të përdorë mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive.</p> <p>Institucioni nismë nga NJSBC, vazhdimisht organizon trajnime të karakterit pedagogjik dhe psikologjik për stafin akademik si dhe atë ndihmës apo administratë për mbarëvajtjen e të gjithë procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kryesisht kriteret ligjore të kualifikimit, pasi ka lektorë të cilët janë ende në proces doktorature. Në kontrollin rastësor që GVJ kreu për dosjet e personelit u vërejt përputhje e profilit të lëndës me specialitetin e pedagogut. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive. Ata kanë fituar një eksperiencë të kënaqshme, janë relativisht të rinj dhe kjo përbën një avantazh të dukshëm. Një pjesë e këtij personeli janë të angazhuar në proces mësimdhënës edhe në universitete të tjera brenda vendit dhe kjo përbën pa asnjë dyshim një avantazh të dukshëm dhe progres të evidentueshëm.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektesë të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Institucioni, kryesisht njësi bazë/Departamenti, vlerëson format e mësimdhënies dhe analizon performancën e këtij procesi. Për këtë Departamenti, si strukturë që drejton programin, analizon periodikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cdo vit akademik bën një analizë të procesit mësimor dhe pedagogjik;</li> <li>• Analizon dhe diskuton përfshirjen e pedagogëve në kërkimin shkencor;</li> <li>• Realizon dhe tërheq opinionin e studentëve lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies;</li> </ul> <p>Kontrollet e vazhdueshme dhe leksionet e hapura të organizuara nga departamenti, identifikojnë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësi i studentëve.</p>





	<i>Evidenca22. Procedura epunës mefokus grupet</i> <i>Evidenca 20. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Personeli akademik përdor diskutime të lira dhe metoda të tjera interaktive në orët e mësimit që synojnë përfshirjen dhe gjallërimin e shprehjes së lirë të ideve dhe të inkurajimit të studentëve për të përfituar nga ky diskutim.  Nga vizita ne institucion mësuam se personeli akademik përpiqet që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës apo realizojnë konkurse dhe vizita studimore, për ta bërë më tërheqëse orën e mësimit, të përdorë case study, apo të përfshijë raste nga tregu lokal.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Programi i studimit, i nivelit master shkencor, i është larguar formës klasike së mësimdhënies. Programi ka karakter sa teorik po aq edhe praktik dhe profesional. Studentët nxiten shumë për punë të pavarur. Midis pedagogëve dhe studentëve dominon respekti i ndërsjellë dhe reciprok si dhe fryma e ndërtimit të marrëdhënieve të ngrohta dhe komunitare.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga vizita që GVJ pati në Institucion, evidentoi se godina e UAMSH që përdorej edhe për këtë plan studimi, mundëson që procesi mësimor e shkencor për të gjitha programet e studimeve të zhvillohet brenda të gjithë parametrave moderne. Sipas orarit të mësimit semestral, studentët zhvillojnë mësimin (leksione dhe seminare) në mjedise të mjaftueshme për numrin e studentëve, të grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Ajo është e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambientet, internet, vende çlodhjeje e qëndrimi, sistem mbrojtjeje nga zjarri, shërbim, etj.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për	Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve janë



<p>realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>të pajisur me kompjutera e projektorë. Godina e UMSH ku zhvillon mësimin ky program studim dhe ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 sipas të cilit kërkohen 2.5 m<sup>2</sup> / student.</p> <p><i>Tabela 16; Evidenca 29. Informacion mbi Infrastrukturën e UMSH"</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>UMSH ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. Nga vizita në godinë dhe gjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, GVJ iu referua se pika të forta në departament mbeten logjistika IT e programet kompjuterike. Gjithashtu, sic e përmendëm edhe më sipër, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisur me kompjutera e projektorë.</p> <p><i>Tabela 16; Evidenca 29. Informacion mbi Infrastrukturën e UMSH"</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë për çdo modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Biblioteka ofron tituj bazë dhe materiale mbështetëse në shqip si edhe në gjuhë të huaj. . Literatura gjendet në bibliotekën e UMSH në versionin fizik, me numër të konsiderueshëm titujsh dhe kopjesh, dhe në formë elektronike në formatin "Fondi i literaturës elektronike të UMSH", të përdorshme nga i gjithë personeli akademik dhe studentët. Bibliotekat online në të cilat ka akses UMSH ofrojnë një masë shumë të madhe literature në gjuhë të huaj në dispozicion të punës më të thelluar nga personeli akademik dhe studentët në fushat e programit/ profilit të tyre. Departamenti informohet për botimet më të fundit në fushat e lidhura me programet e tij dhe planifikon shtimin e tyre në bibliotekë, në përputhje me procedurat e administrimit dhe ato financiare të institucionit</p> <p><i>Tabela 17; <a href="http://biblioteka.umsh.edu.al/">http://biblioteka.umsh.edu.al/</a>; <a href="https://www.e-elgar.com/">https://www.e-elgar.com/</a>; <a href="https://al.cobiss.net/">https://al.cobiss.net/</a></i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet tekste mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazë të planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. GVJ evidentoi që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p>





	<i>Tabela 17; <a href="http://biblioteka.umsh.edu.al/">http://biblioteka.umsh.edu.al/</a>; <a href="https://www.elgar.com/">https://www.elgar.com/</a>; <a href="https://al.cobiss.net/">https://al.cobiss.net/</a></i>
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Referuar RVB-së theksohej për aksesin në librarinë online, por kjo rezultoi se nuk përdorej nga studentët me të cilët GVJ zhvilloi takimin.  Universiteti përfshihet në Bibliotekën Dixhitale të mundësuar nga RASH. <i>Tabela 17; <a href="http://biblioteka.umsh.edu.al/">http://biblioteka.umsh.edu.al/</a>; <a href="https://www.elgar.com/">https://www.elgar.com/</a>; <a href="https://al.cobiss.net/">https://al.cobiss.net/</a></i>
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	UMSH ka salla konferencash dhe ambiente studimi në bibliotekë të cilat janë në funksion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit, diplomave apo edhe prezantimin e tyre. Gjithashtu në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, është edhe një laborator i teknologjisë së informacionit. Në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, UMSH ka vendosur në dispozicion të studentëve të të gjithë programeve 3 laboratorë informatike dhe 1 sallë interneti, ku mund të zhvillohen seminarët që kërkojnë përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të punohet për detyrat e kursit apo punime të tjera akademike. Ato janë të hapura gjatë gjithë ditës për studentët e UMSH  <i>Evidenca 11. Rregullore e DEK, Kreu III, Neni 26;</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile, Kreu VI, Neni 24;</i>
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Komunikimi i brendshëm mes stafit akademik dhe studentëve, bëhet nrm platformës Teams ose adresave të emailit  <i>Evidenca 34 “Udhëzues mbi përdorimin e platformave online”.</i> <i><a href="http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar">http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</a></i>
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Në UMSH komunikimi i brendshëm bëhet përmes faqes së internetit të tij që është platforma SMS (Sistemi i Menaxhimit të Studentit), ku i gjithë personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të gjithë studentët posedojnë një adresë email @umsh  <i>Evidenca 24. Udhëzues ipërdorimit të sistemit SMS</i>
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Studenti ka të drejtë të propozojë sipas dëshires se tij tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë (ose të zgjedhë ndër temat që pedagogët udhëheqës kanë propozuar në Departament), të zgjedhë udhëheqësin e tij dhe në bashkëpunim me të, të përcaktojë temën kërkimore që do të realizojë për mbrojtje Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale. Tezat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga departamenti. Refereuar RVB,



	<p>studentët zgjedhin temën 1 diplomës dhe pedagogun udhëheqës një muaj nga fillimi i vitit akademik.</p> <p><i>Evidenca 11. Rregullore e DEK, Kreu III, Neni 26;</i>  <i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile, Kreu VI, Neni 24;</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është përgjegjëse për të siguruar cilësinë e programeve të studimit në UMSH dhe përmirësuar vazhdimisht mësimdhënien</p> <p>NJSBCZHK e zhvillon aktivitetin e vet sipas një plani kalendar të përvitshëm. Në koordinim me fakultetet dhe departamentet programohen veprimet në njësitë apo proceset që i nënshtrohen kontrollit/ vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik.</p> <p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës në bashkërendim me NJSBC nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët. Vlerësimi i performancës kryhet në fund të cdo viti akademik, ndërsa pyetësori me studentët realizohet para provimeve dhe rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Gjithashtu NJSBC zhvillon edhe grup fokus të studentëve me pjesëmarrje të një numri të vogël studentësh për cdo program studimi dhe që zgjidhen në mënyrë rastësore. Mendimet dhe sygjërimet e marra nga këto grupe fokusi, NJSBC ja vë në dispozicion përgjegjësit të departamentit përkatës, i cili edhe jep përgjigje për marrjen në konsideratë apo apo vënien në zbatim të sygjërimeve. Vlerësimi i stafit akademik gjithashtu bëhet për cdo vit. akademik nga përgjegjësi i departamentit. Vëtë Institucioni realizon pyetësor për të ditur mendimet dhe sygjërimet e stafit mësimdhënës si edhe atë ndihmës në lidhje me mësimdhënien, por jo vetëm</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e Organizimit UMSH, neni</i></p>



	<p>18;</p> <p><i>Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë,</i></p> <p><i>Evidenca 19. Plan pune për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Leksionet e hapura nga lektorë të ftuar të huaj dhe vendas të organizuara në UMSH, marrja e stafit akademik në projektet e mobilitetit me universitetet e huaja, konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, Konferenca Studentore e organizuar me mbështetjen e stafit akademik, kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 21. Programi i trajnimeve 2020-2021</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Aktivitetet kërkimore-shkencore të pedagogëve duke përfshirë edhe studentët në Konferenca Studentore, zenë një vend të rëndësishëm në fokusin e aktiviteteve të UMSH, me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit transmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Kjo gjë konfirmohet dhe në CV e stafit akademik që shikohet se në këto vitet e fundit kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Ky kualifikim i personelit akademik të Fakultetit dhe Departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: tabela 19</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në vazhdimësi personeli akademik i Fakultetit dhe Departamentit të Ekonomisë, kualifikohet brenda institucionit, në zbatim të udhëzuesit të stafit akademik si dhe në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes trajnimeve, diskutimeve, leksioneve të hapura i kanë shërbyer trajnimit të stafit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe të metodave të reja në mësimdhënie.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Ka qënë dhe është në përgjegjësinë e personelit akademik zbatimi i programeve të studimit si dhe transmetimi i metodave të reja në mësimdhënie dhe praktikave mësimore tek studentët. Pedagogu është përgjegjës për të gjitha zërat e detyrave që ai ka në marrëdhënie me studentët për organizimin dhe zhvillimin e mësimin si dhe plotësimin e detyrave që i ngarkon departamenti.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i strukturave drejtuese për t'u siguruar atyre si</p>



rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit.		
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	UMSH ka një sërë marrëveshjes dhe parteritete me Institucione të Arsimit të Lartë në vend dhe jashtë duke zhvilluar herë pas here edhe leksione të hapura. Ky angazhim ka ndihmuar në rrjetizimin e universitetit dhe krijimin e vazhdimësisë së bashkëpunimit me institucionet partnere <i>(Referenca- Tabelat përmbledhëse, tab.5).</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ mendon se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së UMSH realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegiumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës;</li> <li>- detyrave të kursit për problematikën e disiplinës;</li> <li>- provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës;</li> </ul> <p>Skema e vlerësimit është e njëjtë në të gjitha lëndët. Mënyra e vlerësimit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi i ndërmjetëm (20%)</li> <li>• Provimi përfundimtar (60%)</li> <li>• Detyrat e kursit/prezantim/punë në grup (10%)</li> <li>• Pjesmarrja aktive në seminar (10%)</li> </ul>




	Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve <i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion konstatuam se pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerës të syllabusit. Gjithashtu i njeh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës, studentët informohen rregullisht, në fillim të cdo semestri dhe përgjatë tij lidhur me lëndët, me syllabusat e cdo lënde dhe me kërkesat e programit për studentët. Ata njohin detyrimet e tyre dhe kohën e përmbushjes së këture detyrimeve.			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Bazuar në rregulloret e studimeve të UMSH si edhe rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që i ka përvetsuar studentit gjatë zhvillimit teroik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Vlerësimi dhe testimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme të tilla si: vlerësimi me punime të pavarura, ose detyra kursi, një kontroll ose vlerësim të pjesshëm si edhe vlerësimi përfundimtar.  Tezat e provimit dhe të kontrollit janë gjithëpërfshirëse dhe mesatare. Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.  <i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021-2022</i> <i>Evidenca 18. Udhëzues për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Nga verifikimet u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e Departamentit. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë:  1. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit;



	<p>2. Vlerësimi përfundimtar;</p> <p>Këto programe miratohen çdo vit nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><b>Evidenca 4.</b> Rregullore e Organizimit UMSH, neni 18;</p> <p><b>Evidenca 11.</b> Rregullore e Departamentit të Ekonomisë,</p> <p><b>Evidenca 19.</b> Plan pune për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni si edhe nga vizita në Institucion, GVJ nuk evidentoi përdorim të ndonjë sistemi elektronik për testimin apo edhe vlerësimin. Provimet me shkrim sekretohen në momentin e zhvillimit të provimit dhe hapen (csekretohen) në Departament. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Komisionet e provimeve përbëhen së paku nga 2 anëtarë ku njëri prej tyre është pedagogu apo lektori i lëndës dhe tjetri asistenti ose një pedagog që ka të njëjtin profil ose të përafert</p> <p><b>Evidenca 4.</b> Rregullore e Organizimit UMSH, neni 18;</p> <p><b>Evidenca 11.</b> Rregullore e Departamentit të Ekonomisë,</p> <p><b>Evidenca 19.</b> Plan pune për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimin i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Provimet me shkrim sekretohen në momentin e zhvillimit të provimit dhe hapen (csekretohen) në Departament. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi me studentët u informuam që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit. Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.</p> <p>Neni 44-45; <a href="https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme">https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme</a> Evidenca "Udhezuesi i Studentit")</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Komisionet e provimit përbëhen nga të paktën dy pjestarë të stafit akademik të miratuar sipas përcaktimit të rregulloreve. Hartimi i tezave të reja bëhet për çdo sezon provimi. Personelit akademik që ndjek procesin e provimit u ndalon hyrjen në provim personave të jashtëm, Studentëve</p>





	<p>nuk u lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Studentët që në provim përdorin forma e mjete të palejueshme përjashtohen nga provimi. Përsa i përket temave të diplomave udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe mënyrën e referimit të saj.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e Organizimit UMSH, neni 18;</i>  <i>Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë,</i>  <i>Evidenca 19. Plan pune për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Rezultatet e provimit i vihen në dispozicion sekretarisë mësimore brenda 7 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit, e cila njofton studentët individualisht për rezultatin. Gjatë vizitës së GVJ në Institucion, në takimin që pati me sekretarinë mësimore evidentoi se brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve, studenti ka të drejtë të shohë provimin e korrigjuar apo të bëjë ankimim në rast se ka pretendime për rezultat më të lartë.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e Organizimit UMSH, neni 18;</i>  <i>Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë,</i>  <i>Evidenca 19. Plan pune për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orëve). Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit dhe në dorëzimin e tij në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e Organizimit UMSH, neni 18;</i>  <i>Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë,</i>  <i>Evidenca 19. Plan pune për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimeve ose nuk është dakort me vlerësimin e bërë. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili ngre një komision <i>ad hoc</i>, në përbërje të të cilit janë edhe pedagogët e komisionit të provimit. Rezultati përfundimtar pas rivlerësimit i bëhet me dije studentit nga sekretaria mësimore, brenda një jave nga depozitimi i ankesës. Ky vendim i bashkëngjitet procesverbalit të provimit. Kjo është një procedurë por që për këtë program studimi, GVJ ju bë me dije se nuk ka patur raste ankimi për provimet.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e Organizimit UMSH, neni 18;</i></p>



	<i>Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë,</i> <i>Evidenca 19. Plan pune për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit bankar dhe financiar si edhe vendimmarrjes së biznesit <i>Evidenca 4. Rregullore e Organizimit UMSH, neni 18;</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë,</i> <i>Evidenca 19. Plan pune për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Modulet janë të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmblylëse, sipas ligjit. <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile;</i> <i>Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabelës 10 ;</i> <i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulën përkatës. Këtu ato njihen me temat, kohëzgjatjen e kursit, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese. Syllabusi përmban edhe numrin e krediteve të lëndës <i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</i>
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në fund të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim.





<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në këtë program studimi organizohen leksione të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentet me aftësi për tju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapësirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo ju jep mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut</p> <p><i>Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Nga vizita dhe takimi me studentët, konstatoam se personeli akademik krijon një klimë të përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punë kërkimore-shkencore. Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. UMSH organizon Konferenca Studentore, ku studentët kanë marrë pjesë me punime shkencore të tyre, rezultat i mbështetjes së vazhdueshme që i jep personeli akademik.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Shpenzimet e pjesmarrjes dhe të botimit të temave të Konferencës sponsorizohen nga Institucioni. Gjithashtu, në UMSH organizohen edhe konkurse për projekte dhe ide inovative, dhe realizohen me mbështetje këshilluese nga stafi akademik.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurur format e mësimdhënies me vizita në institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga takimi në institucion na u komunikua që nuk ka pasur raste të studentëve master të këtij programi studimi, për mobilitetin në kuadër të marrëveshjeve që ka Institucioni.</p>






Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi III.8**  
**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	UMSH ka procedura te posacme për provimin final dhe mbrojtjen e diplomes. Udhëzuesi për përgatitjen e punimit të diplomës shpjegon të gjithë procesin e realizimit te zgjedhjes, hartimit dhe mbrojtjes së diplomes. Informacioni lidhur me realizimin e procesit të diplomimit iu bëhet i ditur studentëve nga njesia baze dhe nga Sekretaria Mësimore gjatë vitit akademik dhe njëkohësisht është i shpallur në faqen zyrtare te UMSH. Studentët e programit MScAB kanë detyrim akademik mbrojtjen e diplomës.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	DEK përgjegjës për programin e studimit MScAB, cakton pedagogun udheheqes (anetar i departamentit dhe ekspert i fushes) duke konsideruar kerkesen e paraqitur ne departament nga studenti qe ploteson kriteret per diplomim. Lista e fushave/ temave te diplomave dhe pedagoqeve udheheqes, te miratuara nga Departamentiju vihet në dispozicion studentëve (classroom) sipas afateve te percaktuara ne kalendarin akademik të UMSH si dhe depozitohet në bibliotekën dhe sekretarinë mësimore. Departamenti programon seanca konsultimesh për studentët dhe bashkërendon punën me Bibliotekën e UMSH për sigurimin e literaturës. <i>Evidenca 9. Rregullore FSHE, neni 51</i>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studentët e programin te studimit MScAB njihen me fushat dhe temat e sugjeruara nga departamenti për temat e diplomave sipas fushave të ekspertizës së personelit akademik, ju jepen sqarime për procesin dhe ju lihet kohë të konsultohen me pedagogët për sgjedhjen e temës. DEK angazhon personel akademik të kualifikuar me grada e tituj, eksperte te fushes për orientimin, përcaktimin dhe drejtimin e temave të diplomave për studentët. <i>Evidenca 25. Udhëzuespër përgatitjen epunimit te Diplomes</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	DEK në bashkëpunim me FSHE, kanë monitoruar dhe asistuar vazhdimisht studentët e programit të studimit MScAB në aftësimin e tyre për realizimin me sukses të detyrimeve te programit mësimor. Pedagogët punojnë ngushtë me studentët për aftësimin e tyre në analizën dhe gjetjen e literaturës së duhur sipas profilit dhe për vëzhgime në mjedisin e biznesit, kur nevojiten të tilla. Studentëve ju vihen në dispozicion mjediset e UMSH me qëllim mbeshtetjen e punës së tyre studimore.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e	Në udhëzuesin për përgatitjen e punimit të diplomës, janë të shprehur qartë procedurat që ndjek pedagogu udheheqës në ndihmë të realizimit



<p>institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>me sukses të temës së diplomës nga ana e studentit. Roli i udhëheqesit është kryesisht drejtues, keshillues dhe konsultues. Kontributi i udhëheqesit në realizimin e punimit fillon me saktësimin e temës deri në perfundimin e punimit. Udhëheqesi keshillon studentin për përcaktimin e strukturës së temës, nxjerrjen e grupeshtjeve, trajtimin e problemeve teorike praktike, rekomandimin e literatures, përcaktimin e afateve të punës, kontrollin e realizimit të detyrave si dhe formulimin e një teze të qendrueshme.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në udhëzuesin për përgatitjen e punimit të diplomës, janë të shprehur qartë procedurat që ndjek pedagogu udhëheqës në ndihmë të realizimit me sukses të temës së diplomës nga ana e studentit. Roli i udhëheqesit është kryesisht drejtues, keshillues dhe konsultues. Kontributi i udhëheqesit në realizimin e punimit fillon me saktësimin e temës deri në perfundimin e punimit. Udhëheqesi keshillon studentin për përcaktimin e strukturës së temës, nxjerrjen e grupeshtjeve, trajtimin e problemeve teorike praktike, rekomandimin e literatures, përcaktimin e afateve të punës, kontrollin e realizimit të detyrave si dhe formulimin e një teze të qendrueshme</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas përcaktimeve në aktet rregullatore institucionale në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë nga juria e përbërë prej tre anëtarësh. Studentët që vlerësohen me notë kaluese në mbrojtjen e diplomes mbyllin ciklin e dytë të studimeve në MScAB sipas profilit respektiv</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile, neni 24</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UMSH mundëson pajisjen me diplomë të studentëve që kanë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit MScAB si dhe detyrimet ndaj institucionit sipas rregullores së organizimit, kontratës së studimit dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p>Studentët e MScAB me profile, në përfundim të studimeve, pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës titulluar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profil "MARKETING, SHITJE DHE KOMUNIKIM";</li> <li>• Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profil "SIPËRMARRJA DHE INOVACIONI".</li> </ul> <p><i>Evidenca 26. Modeli i diplomës për programin MScAB me profile;</i>  <i>Evidenca 27. Modeli i Suplementit të Diplomës për programin MScAB me profile</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit të programit të studimit MScAB me profile, i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, bazuar në rregulloret dhe procedurat institucionale. Studenti depoziton një kërkesë pranë sekretarisë mësimore dhe brenda afateve të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë, i jepet një kopje e firmosur dhe vulosur e programit të ciklit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile, Kreu VI, Neni 24;</i></p>





	<i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu X, Neni 53, 54.</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Sekretaria Mësimore, nëpërmjet zyrës së saj të pranimeve, ndërton dosjen e plotë personale në format fizik dhe elektronik të studentit, që menaxhohet nga personeli i Sekretarisë Mësimore nga viti në vit. Ajo përmban të dhënat e plota për studentin deri në diplomim dhe pas mbylljes së studimeve nga ana e tij, dosja arkivohet duke respektuar legjislacionin në fuqi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbyset plotësisht</b>	<b>Përmbyset pjesërisht</b>	<b>Përmbyset kryesisht</b>	<b>Përmbyset plotësisht</b>
				X


<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbyset pjesërisht</b>	<b>Përmbyset kryesisht</b>	<b>Përmbyset plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur në dosjen e vetë vlerësimit (DVV) ku specifikohet se informacioni në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ruhen në dy nivele. Të dhënat në lidhje me stafin akademik fillimisht mblidhen dhe depozitohen pranë njësisë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit (në këtë rast Departamenti i Ekonomisë). Në nivelin e dytë, të dhënat në lidhje me stafin, si akademik, ashtu edhe atë drejtues dhe ndihmës mësimor, mblidhen dhe administrohen nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila administron dosjet e plota për çdo anëtar të personelit. Gjatë vizitës në zyrën e MBNJ u evidentuan disa mangësi në mos ruajtjen e dokumentacionit (diploma apo ekuivalente) në origjinal apo të noterizuar në dosjet respektive të të dhënave të personelit akademik. Por kjo gjetje për ato dosje që ne verifikuam me mangësi u adresua në ditën në vijim nga stafi i zyrës së MBNJ.




<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p><i>(Evidenca 4 “Rregullore e Organizimit të UMSH”, neni 37. Evidenca 5 “Rregullore e Programit të Studimit”, nenet 10 &amp; 11.)</i></p> <p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që u bënë pjesë e DVV si edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi formalizimin dhe funksionimin e procedurave për rekrutimin e personelit akademik. Këto procedura paraqiten në përputhje me kërkesat ligjore, pasi kërkohet staf akademik me gradën shkencore Doktor, pra një nivel më lart se niveli i studimeve, Master i Shkencave. Institucioni angazhon, në varësi të nevojave të tij staf akademik me kohë të plotë, me kohëzgjatje të caktuar ose me kohëzgjatje të pacaktuar, si edhe staf akademik me kohë të pjesshme sic u verifikua nga tabelat e të dhënave në RVB. Bazuar në RVB, procesi i seleksionimit të kandidatëve kalon në disa faza, procesi kryhet në mënyre transparente dhe aplikantët njoftohen në secilën fazë, deri në pranimin në punë të kandidatëve të përzgjedhur. Gjatë vizitës në zyrën e MBNJ u kërkua verifikimi për 2 rekrutimet më të fundit (PAE) të na vendosej në dispozicion dokumentacioni që ka shoqëruar gjithë këtë proces, por u konstatua se në dosjet respektive nuk ishin ruajtur dokumentat e kërkua.</p> <p><i>(Evidenca 1 “Statuti i UMSH”, nenet 54 – 59. Evidenca 28 “Përmbledhje e Procedurës së Rekrutimit të Stafit”. Evidenca “<a href="https://www.umsh.edu.al/d/160/konkurs-per-vende-pune-prane-Universitetit-mesdhetar-i-shqiperise">https://www.umsh.edu.al/d/160/konkurs-per-vende-pune-prane-Universitetit-mesdhetar-i-shqiperise</a>”.)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e dorëzuar si edhe njoftimet publike në faqen e internetit të Institucionit për disa njoftime për vende pune të publikuara në faqen e internetit.</p> <p>Cfarë GVJ konstaton është se në nenin 57 të Statuti të UMSH përcaktohen tre kriteret për rekrutimin e personelit, më konkretisht, grada shkencore “Doktor”, Vjetërsia në punë prej 5 vite dhe moshë jo më shumë se 68 vjeç. Por në kërkesën për Staf Akademik, të publikuar në faqen e internetit të Institucionit, specifikohet si kriter vetëm grada shkencore “Doktor” pa dhënë detaje si vjetërsia në punë dhe moshë jo më shumë se 68 vjeç siç kërkohet në Statutin e UMSH.</p> <p>GVJ konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik nuk ka një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. Pra, GVJ këshillon IAL se vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e përbashkët të rezultateve të diplomës Bachelor dhe Master do të ishin të rëndësishme për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe që do të garantonin rekrutimin e personelit akademik cilësor dhe si rrjedhim rritjen e cilësisë së këtij program studimi.</p>







	<i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH", neni 57; Evidenca 4 "Rregullore e Organizimit të UMSH", neni 38 &amp; 39; Evidenca 5. "Rregullore e programit MScAB me profile".)</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Sipas GVB procedura e rekrutimit fillon me konstatimin e vendeve vakante nga ana e njësisë bazë e cila harton një Kërkesë për Rekrutim Stafit akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Njëkohësisht, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, kritere që variojnë sipas nevojave specifike të programit të studimit. Kriteret i dërgohen zyrës së BNJ dhe pasi përpunohen prej saj, përcillen te rektori i cili i miraton ato. Shpallja e njoftimeve për vendet vakante publikohet jo vetëm në web faqen e Institucionit por sipas tyre edhe në rrjete sociale e deri në televizione dhe periodikë. Rektori ngrre një komision të kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit e cila kalon në dy faza: faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të kërkesave të kandidatëve që janë dorëuar pranë zyrës së BNJ, kurse faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport vlerësimi të kandidatëve e cila i përcillet Rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi i Rektorit.  <i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH", nenet 54 – 59. Evidenca 28 "Përmbledhje e Procedurës së Rekrutimit të Stafit".)</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi në vend kushtet e punës dhe mjedisin që i mundësonte personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ kryerjen e detyrave të tyre përkatëse. Mjediset e Institucionit gjenden në një vendndodhje të mirë në qytetin e Tiranës, lehtësisht të aksesueshme. Zyrat ishin të pajisuar me mobilimin dhe pajisjet teknologjike të nevojshme dhe të gjitha ambientet e Institucionit mbuloheshin nga rrjeti ëireless që ofronte Internet për stafin dhe studentët.  <i>(Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike; Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 16)</i>






<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV dhe konstatoi se në dokumentat bazë (Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH, Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi), përmenden synime dhe objektiva të mirëfillta të Institucionit për përmirësimin e stafit akademik.</p> <p>Sipas RVB dhe evidencave (tabelat 19 dhe 20) mund të konstatojmë se kërkimi shkencor i stafit, si edhe marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura mes Institucionit dhe partnerëve të rëndësishëm akademikë dhe të biznesit, tregojnë se UMSH aktualisht është në drejtimin e duhur për aktivitete kërkimore dhe bashkëpunime shkencore. Gjithashtu, nga intervistat me përgjegjësin e departamentit, zv.Rektorin dhe stafin akademik, GVJ u informua se përparësi në financim kanë personat që mbrojnë doktoraturën, dhe si lehtësim mund të kenë reduktim oresh, ose edhe financime për pjesëmarrje në konferenca shkencore. Kërkohej kujdes nga GVB në vendosjen e disa referencave të cilat nuk ishin relevante për këtë kriter.</p> <p><i>(Evidenca 6 “Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH”. Evidenca 7 “Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi”. Referenca nga Tabelat e RVB: Tabela 19 “Kërkimi shkencor i stafit akademik”. Tabela 20 “Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit”.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në DVV, si dhe gjatë takimeve me pedagogët dhe Përgjegjësin e Departamentit të Ekonomisë GVJ konstatoi se Institucioni organizon vazhdimisht aktivitete në kuadër të kualifikimit të mëtejshëm profesional të personelit akademik, për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, dhe së fundmi edhe në kuadrin e përdorimit të teknologjive të reja të mësimdhënies. Bien në sy trajnime për përdorimin e platformës së mësimi online G Suite dhe sistemet “Student Management System”. Plani i trajnimeve për stafin akademik hartohet në fillim të vitit akademik dhe të pyetur mbi nivelin e zbatueshmërisë së tij, stafi u shpreh se ishin trajnuar nga Institucioni.</p> <p><i>(Evidenca 15 “Programi i Trajnimeve 2020-2021”. Evidenca 34 “Udhëzues mbi përdorimin e platformave të mësimi online”.)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Mbështetur tek dokumentat e paraqitura në DVV (Tabelat 1 dhe 2 në evidencën 18: “Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit”) si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomisë, i cili është edhe njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Për vitin akademik 2020 – 2021, Fakulteti Shkencave Ekonomike ka 54 PAE dhe 13 PAK, Departamenti Ekonomisë ka 19 personel akademik efektiv, dhe 2 personel akademik me kontratë. Për vitin akademik 2021 – 2022,</p>




	<p>Fakulteti Shkencave Ekonomike ka 52 PAE dhe 17 PAK, Departamenti Ekonomisë ka 19 PAE, dhe 4 PAK. T dhëna më të detajuara për numrin dhe kualifikimet e personelit akademik janë dhënë më herët në këtë raport Standardi II.2).</p> <p>Sipas GVB, ngarkesa mësimore dhe shpërndarja e saj tek PAE dhe PAK dëshmon për një angazhim të personelit akademik për plotësimin e objektivave të programit të studimit në MScAB. Por nga vizita në IAL dhe takimeve atje, u evidentua se PAE përveç mësimdhënies kryenin edhe detyra të tjera administrative.</p> <p><i>(Evidenca 4. Rregullore e UMSH, Kreu V, Neni 38 -39 Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 4).</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kwrkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se UMSH e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij. Në kampus ka edhe ambiente në shërbim të mësimi si bibliotekë, sallë interneti, etj.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV (Evidenca 18, tabela 16), GVJ konstaton se në funksion të fakultetit / departamentit ka në dispozicion salla për leksione dhe për seminare, 1 sallë interneti, 1 sallë për bibliotekë dhe laboratorë kompjuterësh përveç ambienteve të tjera mbështetëse për programin si mjedis për fotokopje, zyra informimi, zyra për stafin dhe drejtuesit, etj.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL dhe takimeve atje, nuk u evidentua asnjë adresim i bërë për rekomadnimin e dhënë nga që prej akreditimit institucional për UMSH ku i kërkohet të zgjeroj ambientet për zhvillimin e programeve studimore, ku pjesë e tyre është edhe programi studimit MscAB I cili ka mbi 400 student aktivë (viti i parë</p>





	<p>dhe i dytë). GVJ, sjell në vëmendje UMSH të marrë masat për plotësimin e rekomandimit të bordit të ASCAL.</p> <p><i>(Evidenca 8. "Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile"; Tabela 16.)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologji e teknologji bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV (Evidenca 18, tabela 16), GVJ konstatoi se ambientet mësimore në UMSH ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor teorik e praktik. Laboratorët kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse te nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike.</p> <p><i>(Evidenca 8. "Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile"; Tabela 16.)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ka në dispozicion laboratorë informatike (Tabela 16, evidenca 18). Ata janë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programe profesionale si: Alpha dhe Financa 5, SPSS apo programi i Business English, të cilat mund të ndihmojnë dhe aftësojnë studentët nga ana praktike. Ato janë në dispozicion të studentëve për t'u shfrytëzuar për realizimin e detyrave të kursit apo punimet e diplomës.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Shfrytëzimi i këtyre laboratoreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit, pavarësisht se studentët u shprehën që nuk kishin kohë të shkonin aty për të punuar.</p> <p><i>(Evidenca 8. "Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile"; Tabela 16.)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Shfrytëzimi i këtyre laboratoreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit, pavarësisht se studentët u shprehën që nuk kishin kohë të shkonin aty për të punuar.</p> <p><i>(Evidenca 8. "Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile"; Tabela 16.)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Për këtë kriter, në RVB të përgatitur nga Institucioni listohen disa mundësi të zhvillimit të praktikave profesionale apo veprimtarive të tjera aplikative praktike në bashkëpunim me institucione të tjera.</p> <p>Në dokumentacionin e dorëzuar në DVV, në evidencën 19, GVJ gjen disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave nga ana e studentëve. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale janë hartuar me qëllim që studentët përveç anës teorike të mësojnë dhe anën praktike. Po kështu, gjatë vizitës në Institucion, studentët konfirmuan angazhimin e UMSH për praktikat e tyre.</p> <p><i>(Evidenca 8. "Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile"; Tabela 5. ; <a href="https://www.umsh.edu.al/d/317/bashkepunimi-">https://www.umsh.edu.al/d/317/bashkepunimi-</a></i></p>





	<i>20-studente-te-rinj-te-universitetit-mesdhetar-punesim-6-muaj-ne-banke: Programi "Students Direct Sales", punësohen në Bankë part-time 25 studentë të UMSH)</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sipas verifikimeve të dokumentacionit (tabela 16 në RVB) të kryera nga GVJ, Institucioni raporton se disponon salla për biblioteka. Këto salla, sic u konstatua në vend, në fakt ishin ambiente të përshtatshme për lexim e studim, por bibliotekë e mirëfilltë ishte vetëm një hapësirë kryesore e vetme. GVJ gjatë vizitës në Institucion, konstatoi se salla e Bibliotekës ishte e pajisur me ndricim jo natyral, me sistem ngrohje/ftohje, me raftë, rreth 30 poste pune në total, 8 poste me kompjutera, dhe orari i funksionimit ishte 8.30 – 20.00. Kjo sallë është në dispozicion të të gjithë studentëve të Institucionit dhe mund të konsiderohet shumë e vogël për kapacitetin e studentëve që ndjekin studimet në UMSH (kujtojmë se vetëm në këtë program studimi MscAB janë duke studiuar rreth 400 studentë).  <i>(Evidenca 18 "Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit". Tabela 16; Evidenca 29. Informacion mbi Infrastrukturën e UMSH".)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni referohet se në Bibliotekat e Institucionit mund të gjenden fizikisht gjithsej 4.440 tituj librash në rreth 26.424 kopje gjithsej. Tekstet në bibliotekë janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera, kryesisht atë angleze. Meqënëse në DVV nuk u gjetën dokumentacione bazë në lidhje me përmbajtjen e titujve në bibliotekë, gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi në vend, tituj në bibliotekë të cilët janë të pakët dhe GVJ sugjeron shtimin dhe zgjerimin e tyre, pavarësisht se për këtë program studimi mund të përdoren libra dhe literaturë online e cila gjendet me bollëk edhe në UMSH me mbi 327.000 tituj librash në format elektronik.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni referohet se në bibliotekën elektronike ka mbi 327 000 tituj librash. Ky fond librash janë në dispozicion të personelit dhe studenteve të



	<p>UMSH pa pagese, ne funksion të punës mësimore dhe shkencore sipas fushave të interesit.</p> <p><i>(Evidenca 18 “Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit”. Tabela 17; <a href="http://biblioteka.umsh.edu.al/">http://biblioteka.umsh.edu.al/</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në sallat e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim aksesit në Internet nëpërmjet rrjetit ëireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online të UMSH. Por nga ana tjetër në bibliotekë kishte vetëm 30 poste kompjuterike nga të cilat vetëm 8 me kompjutera. GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë. Sugjerojmë shtimin e kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve dhe të stafit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni, për këtë kriter deklarohet se UMSH angazhohet në nxitjen e njësive kryesore dhe njësive bazë që cdo vit të paraqesin kërkesat e tyre për tituj të rinj në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që secila prej tyre ofron. Një pjesë e tujve të rinj të shtuar së fundmi në bibliotekë janë edhe botime të personelit akademik të Institucionit.</p> <p>Në DVV, nga ana e GVJ nuk u konstatua asnjë plan konkret për shtimin e titujve të rinj në bibliotekë. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik u shpreh se kerkesat e pedagoqeve për tekste të reja mblidhen nga shefi i departamentit i cili ia percjell dekanit dhe ky administratorit. Pedagogët u shprehën se kanë mundësi të kenë tekstet e duhura dhe në kohë.</p> <p>Meqënëse gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV apo referencave në RVB për këtë kriter, GVJ nuk gjeti ndonjë dokument që vërteton ekzistencën dhe për më tepër implementimin e një plani të detajuar të pasurimit të zërave të bibliotekës, sugjerohet hartimi i një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet me këtë program studimi.</p> <p><i>(Evidenca 23. Kërkesë për libra Departamenti i Ekonomisë)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Salla e Bibliotekës së Institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre duhet të koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin në programet e studimit. Biblioteka kishte 8 poste pune me kompjuter, dhe 30 poste pune në total. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Oraret e funksionimit të sallave në</p>




	<p>periudha normale ishin nga ora 8.30 – 20.00. Nga ana e GVJ kjo fashë orare konsiderohet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor për atë numër të studentëve të programit të studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi dhe kjo gjë u konfirmua edhe nga vetë studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u vu në dijeni nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar në DVV se UMSH ka në përdorim dhe shfrytëzon një sistem të automatizuar të menaxhimit të informacioneve në lidhje me gjeneralitetet dhe ecurinë e studentëve. Sistemi SMS – Student Management System mundëson koordinimin e punës mes stafit akademik dhe atij mbështetës nga njëra anë dhe studentëve nga ana tjetër. Sistemi ofrohet në gjuhën shqipe dhe sic referohet në RVB është funksional duke filluar që nga dhjetori 2017. Sistemi ka akses të dedikuar dhe të vecantë për stafin akademik dhe për studentët dhe funksionon edhe me akses nga jashtë institucionit. Sic u informuam gjatë vizitës në Institucion, ky sistem kishte përdorim të gjerë nga ana e stafit dhe studentëve dhe atyre u ofroreshin trajnime përgatitore për përdorimin e sistemit. Sistemi SMS përdorej gjerësisht edhe nga ana e stafit administrativ. Të dhënat mund të përditësohen elektronikisht, përveçse mbahen në hard-copy në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore. Ndërsa, të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar) dhe të gjitha regjistrat në formë të shkruar dhe në version elektronik, janë në administrimin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p><i>(Evidenca 31 “Manual përdorimi i SMS për pedagogët”. Evidenca 34 “Udhëzues mbi përdorimin e platformave online”. <a href="http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar">http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</a> )</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i Menaxhimit të Studentëve, SMS është një sistem i cili mundëson administrimin e të dhënave për studentët dhe jo për aktivitetet e personelit akademik.</p> <p>Në RVB për këtë kriter nuk u gjendën të dhëna të dobishme dhe as referenca që mund të shfrytëzoheshin nga GVJ. Dokumentacioni apo</p>



	<p>aktivitetet e personelit akademik, ndihmës akademik apo partnerëve menaxhohen nga Zyra e BNP e cila ka një sistem informacioni manual.</p> <p>GVJ këshillon që zgjerimi i sistemit aktual SMS ose implementimi i një sistemi tjetër për menaxhimin e të dhënave për personelin do ishte e nevojshme për përmbushjen e këtij kriteri.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sikurse referohet në RVB të përgatitur nga Institucioni dhe sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion, nga ana e GVJ, sistemi SMS ofron akses të dedikuar në dokumentacionet e nevojshme duke pasur dy panele aksesit: paneli i dedikuar për stafin akademik dhe ndihmës dhe paneli i dedikuar për studentët.</p> <p>Nëpërmjet sistemit SMS, stafi akademik mund të realizojë shumë funksione të ofruara nga modulet e ndryshme të sistemit, si psh., modifikojë të dhënat personale në modulën „profili im“, të kontrollojë klasat mësimore, të realizojë hedhjen e notave dhe të kontrollojë kërkesat për rishikim, të kontrollojë planet mësimore për cdo lëndë, etj.</p> <p><i>(Evidenca “Manual përdorimi i SMS për pedagogët”; Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike.)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas të dhënave të referuara në RVB, sistemi SMS i UMSH, mundëson ndërveprimin mes aktorëve të institucionit duke lejuar hapjen dhe menaxhimin e adresave personale të emailit. Më shumë informacion në lidhje me sistemin, GVJ mori gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Gjithashtu, u konstatua se për të menaxhuar në mënyrë sa më efektive procesin mësimor online, gjatë vitit akademik 2020-2021 Institucioni implementoi edhe platformën G Suite me komponentët Google Classroom dhe Google Meet.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion u konfirmua se kjo platformë ishte e llojit: “academic account” duke ofruar facilitate të konsiderueshme për pjesëmarrësit. Por, GVJ konstatoi se G Suite nuk është e integruar me sistemin SMS.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të sstudentëve në UMSH, është një sistem që mundëson kontrollin në kohë reale të frekuentimit të mësimin nga ana e studentëve dhe e stafit. Kjo referohet në RVB të përgatitur nga institucioni por konstatohet edhe në evidencën “Manual përdorimi i SMS për pedagogët”. Megjithatë, sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion sistemi nuk mundëson gjenerimin e raporteve individuale dhe të dhëna në kohë reale përtej atyre që kanë të bëjnë me mësimdhënien.</p> <p><i>(Evidenca 31 “Manual përdorimi i SMS për pedagogët”).</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të departamentit përgjegjës për këtë program</p>





paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	<p>studimi, gjenden të qarta dhe të detajuara në faqen e web-it të universitetit (sipas disa referencave në links më poshtë). GVJ konstatoi se informacionet në lidhje me stafin e angazhuar në këtë program studimi janë të kufizuara dhe për shumë prej tyre mungon një bio e shkurtër prezantuese.</p> <p>Informacionet nuk janë vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhën anglisht<sup>1</sup>, kjo tregon reflektim të IAL për një prej rekomandimeve të dhëna në vlerësime të disa muajve më parë.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorzuar në DVV, UMSH përcakton në Statutin pikat që lidhen me buxhetin dhe aspektet financiare ( <i>Evidenca 1, "Statuti i UMSH", nenet, 24, 45</i> ). Sipas statutit buxheti hartohet nga Administratori i Universitetit bazuar në një plan afatmesëm 3 vjeçar, Planin Strategjik të Institucionit dhe nga propozimet e marra nga strukturat e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë. Ai aprovohet nga Bordi i Administrimit të UMSH dhe është i realizuar në përputhje me standardet ligjore.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Evidencë për informacione financiare të lidhura me të ardhurat dhe kostot gjendet në DVV si pjesë e të dhënave financiare institucionale (evidenca 17), dhe në tabelën 18 në evidencën 8. Vlen të theksohet se informacioni i përfshirë në këto dy evidenca është shumë i përmbledhur në rang institucional dhe në asnjë moment nuk i referohet vetëm programit të studimit në fjalë. Vec kësaj, në asnjë nga këto evidenca nuk u gjetën informacione në lidhje me kostot specifike të programit të studimit; apo informacion për pasurimin e bibliotekës, etj.  ( <i>Evidenca 1 "Statuti i UMSH". Evidenca 2 "Rregullore e Organizimit të UMSH"; Tabela 18 "Të ardhurat dhe financimi..." në Evidencën 8 "Përmbledhëse e Tabelave të RVB". Evidenca 22 "Analizë vjetore e FSHE"</i> )
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e	Përgjigja për këtë kriter në RVB ishte teorik, nuk ka evidenca dhe mungon raporti auditimit.

<sup>1</sup> <https://www.umsh.edu.al/eng>



<p>financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Për të analizuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri, GVJ u mbështet në analizën e RVB dhe tabelave mbështetëse të saj, si edhe dokumentacionit shoqërues, pjesë e DVV.</p> <p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni, kontrolli buxhetor realizohet nga Administratori dhe synon të garantojë përdorimin eficient të burimeve të Universitetit, në funksion të arritjes së objektivave të tij. Sipas DVV, detyrë e Administratorit është pikërisht ndjekja dhe kontrolli i zbatimit të buxhetit vjetor dhe paraqitja në përfundim të cdo viti akademik para Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik të raportit të veprimtarisë financiare.</p> <p>Në vijim të analizës së shkallës së përmbushjes së këtij kriteri, nga shqyrtimi i tabelës 18 në evidencën 8, GVJ konfirmon se Institucioni ka paraqitur nja plan financiar institucional të krahasuar buxhet kundrejt faktit që nga viti akademik 2018-2029. Këto evidenca nuk specifikojnë ndërhyrjet e posaçme apo diversifikimin e financimit të programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi. Elemente të tilla nuk i ndeshëm as në evidencën “Analizë Vjetore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike”.</p> <p><i>(Evidenca 1 “Statuti i UMSH”. Evidenca 2” Rregullore e Organizimit të UMSH”. Tabela 18, Evidenca 8 “Përmbledhëse e Tabelave të RVB”. Evidenca “Analizë vjetore e FSHE”).</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Në bazë të informacioneve financiare të dhëna në tabelën 18, GVJ konstaton se Institucioni rezulton me fitim. Megjithatë nuk jepen informacione më të plota që të lejojnë GVJ të formojë një opinion të plotë në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të Institucionit.</p> <p><i>(Tabela 18, Evidenca 8 “Përmbledhëse e Tabelave të RVB”. Evidenca “Analizë vjetore e FSHE”)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të RVB (evidencat 3, 4 dhe 5), u konstatua se Institucioni ka hartuar politika dhe procedura të plota të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e nevojshme të ciklit të studimeve duke filluar që nga kriteret e hyrjes së studentëve, transferimet e tyre në hyrje dhe në dalje, kalimin nga një vit në tjetrin, dhe diplomimin e tyre në përfundim të ciklit të studimeve. Të gjitha kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me këkesat e Ligjit Nr. 80/2015, dhe udhëzimet e MASR.</p> <p><i>(Referenca nga DVV: Evidenca 3: "Strategjia e zhvillimit të programit MScAB me profile"; Evidenca 4: "Rregullore e organizimit të UMSH". Evidenca 5 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi"; <a href="https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme">https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme</a>.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Ekonomisë dhe GVB, GVJ u informua se numri i studentëve që pranohen në këtë program studimi i propozohet nga Departamenti.</p> <p>Kandidatët që dëshirojnë të frekuentojnë programin e studimit "Master i Shkencave në Administrim Biznesi duhet të plotësojnë kriteret e renditura në nenin 12 të dokumentit "Mbi pranimet e studentëve", të cilat lidhen me përfundimin e studimeve Bachelor me 180 ECTS pranë një universiteti tjetër publik ose privat shqiptar ose shqipfolës dhe njohja e një prej pesë gjuhëve të BE.</p> <p>Në programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile mund të pranohen edhe kandidatë pa plotësim kreditesh por nëse kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në shkencë ekonomike pranë UMSH, ose ciklin e parë të studimeve në Administrim Biznesi ose profile të ngjashme pranë një Universiteti tjetër në Shqipëri ose jashtë, gjithmonë në përputhje me kriteret e njehsimit të diplomave. Sipas Rregullores së Programit të Studimit, pranimi i këtyre studentëve në programin e studimit</p>



	<p>MScAB i nënshtrohet fillimisht ekuivalentimit të diplomës nga komisioni i ngritur nga Dekanati dhe miratuar nga Rektori. Në këtë procedurë përcaktohen edhe kreditet shtesë që kandidatët duhet të plotësojnë para hyrjes në programin e studimit. Gjatë vizitës në IAL, konfirmuan po këtë procedurë.</p> <p>Kriter për mesataren nuk ka dhe as për profilin e studimeve të ciklit të parë për ata kandidatë që kanë marrë 180 ECTS. GVJ këshillon përfshirjen e një kriteri për mesataren si edhe profilin në shkencë ekonomike për nivelin Bachelor, duke qënë program studimi i Masterit Shkencor dhe duhet të ketë një nivel të cilësisë në hyrje për kandidatët. Kjo gjithashtu do të garantonte një lloj barazie mes aplikantëve të ndryshëm përsa i përket kontekstit të studimeve të tyre paraprake dhe nivelit akademik të tyre.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu X, Neni 80; Evidenca 4. Rregullore e UMSH, Kreu I, Neni 2; Kreu II, Neni 4, pika 4-5; Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu I, Neni 1; Kreu VII, Neni 30, 32; Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile, Kreu I, Neni 1; Kreu III, Neni 12)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga shqyrtimi i gjithë dokumentacionit të paraqitur, GVJ formoi bindjen se kriteret e pranimit, të përzgjedhjes dhe ecurisë së studentëve përgjatë programit të studimit MScAB janë transparente, pjesë e dokumentacionit zyrtar të Institucionit (si Statuti i UMSH apo Rregullorja e Programit të Studimit), dhe për më tepër janë publikuar edhe faqen e internetit të Institucionit.</p> <p><i>(Referenca nga DVV: Evidenca 1 “Statuti i UMSH”. Evidenca 3 “Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike”. Evidenca 5 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi”. <a href="https://www.umsh.edu.al/c/4/studimet">https://www.umsh.edu.al/c/4/studimet</a>. <a href="https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat">https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, referohet se Institucioni harton dhe bën publike para çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe referon për këtë procedurën e parashikuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike (neni 32, pika 2). Kriteret e pranimit për programin MScAB me profile rishikohen çdo vit nga departamenti në bashkëpunim me FSHE dhe janë në përputhje të plotë me LALKSH 80/2015 dhe me rregulloren e FSHE dhe të programit të studimit.</p> <p><i>(Referenca nga DVV: Evidenca 3 “Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike” Neni 32, pika 2; Evidenca 5. Rregullore e programit MscAB”, Kreu III, Neni 12 dhe 13;)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e</p>	<p>GVJ konfirmon se UMSH publikon një sërë udhëzimesh në faqen e internetit të institucionit që lidhen me rregullore dhe procedura të pranimit në programet e studimit. Vec kësaj, nga bisedat me përfaqësues të Zyrës</p>



kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	e Këshillimit të Studentit dhe Karrierës, u pranua se bëhej një punë e konsiderueshme për informimin e të interesuarve. ( <a href="https://www.umsh.edu.al/c/46/udhezime">https://www.umsh.edu.al/c/46/udhezime</a> )		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi V.2


**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e UMSH. Rregulloret u vihen në dispozicion studentëve dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet që kanë studentët me përgjegjësin e departamentit të DE në bashkëpunim me strukturat e tjera organizative të UMSH kur organizojnë javën e parë për çdo viti akademik ku kryhet edhe prezantimi i programit, rregulloreve, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve.</p> <p>Gjithasht, nëpërmjet sekretarisë mesimore, ata informohen për orarin mesimor, frekuentimin, datat e provimeve, të cilat gjenden edhe në faqen online të UMSH si edhe tek shërbimi informacionit në hyrje të UMSH.</p> <p><i>(Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu III, Neni 14-26; Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile, Kreu IV dhe Kreu i V; <a href="https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet">https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet</a>)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	<p>Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e Departamentit dhe të FSHE përcaktohen procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të UMSH në shkolla të tjera. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni ad-hock i Ekuivalentimit. Të gjitha këto ju bëhen me dije studentëve paraprakisht.</p> <p><i>(Evidenca 9. "Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike", Kreu VIII, Neni 44-45; <a href="https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme">https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme</a> Evidenca "Udhezuesi i Studentit")</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në syllabull të cdo lënde. Meqënëse programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mesimit, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në cdo lëndë çdo fillim semestri, ditën e parë të javës së parë. <i>(E Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021-</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)






	2022; Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile, Kreu i V, Neni 21-23 dhe Kreu VI, Neni 24; Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu VIII, Neni 35-43; Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë, Kreu III, Neni 18-26.)		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Departamentit të Menaxhimit, dhe të programit përkatës të studimit. Institucioni ka hartuar edhe një udhëzues mbi punimin e diplomës që u bëhet i njohur studentëve nga takimet me përgjegjës in departamentit dhe pedagogët udhëheqës të tyre. (Evidenca 5. Rregullore e programit MSCAB; Evidenca "Udhëzim për përgatitje Diplome"; <a href="https://www.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit">https://www.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit</a> )		
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	UMSH në fillim të çdo viti akademik organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Këto informacione përcillen edhe përmes panairove apo masmedias, si edhe përgatitjes së fletëpalosjes dhe posterave për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij. Gjithashtu, UMSH ka vendos shumë rol që studentët potencialë mund t'a marrin informacionin për programin e studimit pranë sekretarisë mësimore. Studentët informohen për të gjitha detajet e programit të studimit edhe përmes broshurës së studimeve master.  ( <a href="https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres">https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres</a> Evidenca 14. Broshura e studimeve Master)		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e universitetit, në llogarinë individuale të Studentëve në SMS si edhe një informacion i përgjithshëm shfaqet në faqen e internetit të UMSH, ku kurrikula ngelet për t'u përditësuar.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në



	<p>orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës, por edhe një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambjentet e institucionit.</p> <p><i>(Evidenca 6. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile; Evidenca 14. Broshura e studimeve Master;</i>  <a href="https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres;">https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres;</a>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/103/fakulteti-i-shkencave-ekonomike;">https://www.umsh.edu.al/c/103/fakulteti-i-shkencave-ekonomike;</a>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/103/fakulteti-i-shkencave-ekonomike">https://www.umsh.edu.al/c/103/fakulteti-i-shkencave-ekonomike)</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Referuar RVB, UMSH mbështet veprimtari në funksion të punësimit si pjesëmarrje në panaire, organizime takimesh me profesionistë të secilit profil, etj.</p> <p>Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që regjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH-s, rrjeteve sociale, leksioneve të hapura, takimeve dhe informimeve të kryera nga ZKSK. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione publike dhe biznese, si edhe zhvillimin e aktiviteteve me institucione shtetërore, kompani private dhe me zyrat e punës që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve.</p> <p><i>(<a href="https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres">https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres</a>  Evidenca 14. Broshura e studimeve Master ;)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e FSHE, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e UMSH lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. DE mbështetet edhe nga njësitë e tjera ndihmëse si Sekreteria Mësimore, Biblioteka, ZKSK, etj</p> <p><i>(Evidenca 14. Broshura e studimeve Master;</i>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/103/fakulteti-i-shkencave-ekonomike;">https://www.umsh.edu.al/c/103/fakulteti-i-shkencave-ekonomike;</a>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/174/njoftime">https://www.umsh.edu.al/c/174/njoftime)</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UMSH kujdeset për Menaxhimi i Sistemit të Informacionit “SMS” i cili synon koordinimin e punës së stafit akademik me stafin administrativ dhe studentët. Nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH, studentët mund të komunikojnë në distancë me pedagogët, ose të shikojnë të dhënat që ata kanë hedhur në këtë sistem. Gjatë vizitës në IAL dhe intervistave me stafin akademik por edhe GVB na u referua se çdo pedagog ofron komunikimin elektronik me studentët.</p> <p><i>(<a href="http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar">http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Referuar RVB, Sekretaria Mësimore ndërton dosjen personale në format elektronik të çdo studenti dhe këto dosje menaxhohen nga personeli i Sekretarisë Mësimore nga viti në vit. Pas diplomimit, dosjet e çdo studenti arkivohen duke respektuar kërkesat në fuqi për arkivat.</p>





	Gjithashtu, UMSH kujdeset për Menaxhimi i Sistemit të Informacionit “SMS” i cili synon koordinimin e punës së stafit akademik me stafin administrativ dhe studentët. Gjatë vizitës në IAL, nuk arritëm të verifikojmë nëse SMS funksionon përsa citohet në RVB.  ( <a href="http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar">http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</a> )		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	UMSH mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në këtë program studimi. Sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore të FSHE.  (Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve në Evidencën 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCAB; Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu IV, Neni 26; )
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Sekretaria mësimore, nëpërmjet regjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit për çdo vit akademik. Bazuar në të dhënat sipas tabelës 21 në evidencën 18, konstatojmë se: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numrin e studentëve të regjistruar në vitin 2020-2021 ishte 220 studentë me notë mesatare në hyrje në nivelin 6.6.</li> <li>• Numrin e studentëve të regjistruar në vitin 2021-2022 ishte 183 studentë me notë mesatare në hyrje në nivelin 6.8.</li> </ul> <p>Numri i studentëve të regjistruar në këtë program ka një rënie të lehtë nga viti akademik 2020-2021 në 2021-2022, ndërsa rezulton edhe me një rritje të lehtë të notës mesatare nga 6.6 në 6.8 (Evidences 18). (Tabela 21. “Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve” në Evidencën 18. “Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCAB”)</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria mësimore regjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna mbahen dhe përditësohen elektronikisht dhe në hard copy në regjistrat e notave dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




	<p>të diplomave të Sekretarisë Mësimore. Të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar).</p> <p>Gjatë vizitës në Sekretari Mësimore u kërkuan të verifikohen rregjistrat e studentëve të transferuar në hyrje apo në dalje, si edhe studentët e padiplomuar përsa kohë mund të jenë ende të rregjistruar përtej kufirit të kohës së lejuar (dyfishi i kohës së studimit që do të thotë 4 vjet akademik). Nga sekretaria na u bë me dije se: nuk kanë ç'rregjistrime sepse ende nuk është plotësuar periudha 4 vjeçare akademike. Në të shkuarën kanë pasë të çrregjistruar të cilët kanë tejkaluar afatin 4 vjeçarë)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ verifikoi me përzgjedhje disa të dhënat të studentëve të programit të studimit MSCAB, të cila përfshinin të dhënat personale, numrin e matricullimit, vlerësimet, etj. Këto të dhëna sipas Kryesekretares menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit pranë Sekretarisë Mësimore. Të gjitha këto të dhëna gjenden dhe menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit nën kujdesin dhe përgjegjësinë e Sekretarisë Mësimore.</p> <p><i>(<a href="http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar">http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</a> Evidenca "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"; Evidenca 24. Udhëzues i përdorimit të sistemit SMS)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>GVJ konstaton nga tabela 21 në evidencën 18 "Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCAB"se, IAL ka përpunuar disa të dhëna analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje por jo në dalje të studentëve, si edhe nëse është i punësuar apo jo. Evidentojmë se kaq nuk është e mjaftueshme për t'u konsideruar një raport mbi profilin e studentëve dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, dhe për më tepër që aty mungojnë masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Në përfundim GVJ rekomandon që Zyra e Karrierës të shkëputet nga varësia e NJSBC dhe të dalë si zyrë më vete me qëllim ndjekjen efektive të ecurisë së ALUMNI dhe tërheqjen e mendimeve të tyre në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>(Tabela 21 dhe 23 në Evidencën 18. "Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCAB")</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Standardi V.5**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” si dhe neni 81, pika c, të Statutit të UMSH institucioni duhet të angazhojë studentë dhe/ose përfaqësues të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të UMSH. Sipas RVB-së, studentët në UMSH janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të Këshillit Studentor. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu X, Neni 83; Evidenca 4. Rregullore e UMSH, Kreu VIII, Neni 58; Evidenca “Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor”.)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga GVB nuk evidentohet qartë garantimi dhe përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetës reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi nga GVB të shprehin si plotësohet ky kriter në UMSH dhe në çfarë strukturash ka përfaqësim nga studentët? GVB evidentoi se studentët janë në klubin e studentëve, në këshillin e studentëve ku gjenden senatorët e çdo viti dhe programi, etj.</p> <p>Por, studentët e pyetur gjatë vizitës në IAL për këtë kriter nuk kishin informacion se kush i përfaqësonte ata në strukturat vendimmarrëse apo vlerësuese të procesit akademik.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu X, Neni 83; Evidenca 4. Rregullore e UMSH, Kreu VIII, Neni 58; Evidenca 40. Rregullore e ZKSK; <a href="https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor">https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se ky program studimi është i mirë hartuar në drejtim të mbajtjes në konsideratë të ngarkesës akademike të studentëve dhe ndarjes sipas Veprimtarive Formuese nga A në E në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018. Gjithashtu, referuar statuti të UMSH dhe rregulloreve përkatëse parashikojnë procedurë joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme në përputhje me kriteret ligjore në RSH.</p> <p><i>(Evidenca 5. “Rregullore e Programit të studimit MSCAB”. Tabela 9 dhe 10 në Evidencën 18. “Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCAB”)</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në UMSH alikohen disa metoda për përfshirjen me qëllim tërheqjen e mendimit të studentëve lidhur me procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Ato janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Përmes formularëve për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndëve.</li> <li>● Mbledhjet e hapura të Departamentit dhe Këshillit Studentor.</li> <li>● Përmes studentit si përfaqësues në Senat.</li> <li>● Përmes studentit si përfaqësues në NJSBC.</li> <li>● Përmes fokus grupeve.</li> </ul> <p>GVJ kërkoi nga NJSBCZHK disa raste konkrete të ilustruara për çfarë është marrë në konsideratë mendimi i studentëve të këtij programi Studimi. Pergjigja nga drejtuese e NJSBCZHK ishte se nga Studentët nuk ka pasa asnjë pretendim apo sugjerim për përmirësime.</p> <p><i>(Evidenca 23. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studentët)</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Bazuar në disa evidence të paraqitura nga GVB evidentohet se studentëve të këtij programi ju mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë si edhe e drejta për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e rezultateve dhe reflektimin e ndryshimeve. Evidencat janë statuti i UMSH dhe kuadri rregullator. Lidhur me rezultatet e provimeve, mbas çdo provimi brenda dy ditëve që është koha e korigjimit të provimeve, studentët informohen për rezultatet dhe nëse ka pakënaqësi ata kanë të drejtë konsultimi me pedagogët respektivë dhe pastaj nëse nuk bien dakort bëhet ankimimi pranë DE.</p> <p><i>(Evidenca 1 Statuti i UMSH.pdf. (Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu VIII, Neni 42; Evidenca 11. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë, Kreu III, Neni 23; Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile, Kreu V, Neni 23; Evidenca "Udhezim për provimin e ndermjetem, perfundimtar dhe te sezonit perserites").</i></p>		
<p><b>Shkalla e përnabushjes së standardit</b></p>	<p>Përnabushet plotësisht</p>	<p>Përnabushet kryesisht</p>	<p>Përnabushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ vlerëson me konsideratë të lartë stafin akademik me kontratë dhe ata efektiv dhe si rrjedhim edhe pjesëmarrjen e tyre në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare. Gjithashtu, vet UMSH raporton se vlerëson</p>



	<p>periodikisht si në aspektin sasior ashtu dhe në atë cilësor nivelin e kërkimit Shkencor të stafit akademik.</p> <p>Pavarsisht sa më sipër, GVJ nuk ka mjaftueshëm evidenca të qarta për progresin e PAE në drejtim të pjesëmarrjes së tyre në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare me kërkime shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>GVJ evidenton angazhime konkrete në drejtim të lidhjes nga UMSH të marrëveshjeve me institucione të huaja të arsimit të lartë, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. Konkretisht ato janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunimi me rrjetet universitare EMUNI dhe EURAS për unifikimin e lëndëve të veçanta të kurrikulës për programet e studimit.</li> <li>• Pjesëmarrja në projekte që financohen nga BE, me kontribut në hartimin e kurrikulave të reja dhe përmirësimin e kurrikulave ekzistuese, etj.</li> </ul> <p>(Evidenca: “Marreveshjet e Bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera.”  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/56/aktivitete-2019">https://www.umsh.edu.al/c/56/aktivitete-2019</a>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/60/projektet">https://www.umsh.edu.al/c/60/projektet</a>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/113/nderkombetarizimi">https://www.umsh.edu.al/c/113/nderkombetarizimi</a>);  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/182/erasmus-">https://www.umsh.edu.al/c/182/erasmus-</a>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkëpunime-dypaleshe">https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkëpunime-dypaleshe</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>RVB nuk ka evidence të qarta lidhur me këtë kriter pasi ashtu si edhe më herët në këtë RVJ nuk evidentohet angazhimi i personelit akademik në nxitjen dhe bashkëpunimin me studentët e këtij programi për hartimin, shkrimin dhe publikimin e studimeve e punimeve shkencore.</p> <p>GVJ, sjell në vëmendje të IAL të nxiten studentët e këtij programi, pasi është master shkencor, në shkrimin dhe publikimin e studimeve/punimeve shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar të dhënave në tabelën 19 të evidencës 18 “Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit MSCAB” konstatohet se stafi akademik i FSHE (nuk ka specifikim vetëm për stafin akademik të angazhuar me këtë program Studimi) ka një pjesëmarrje të konsiderueshme në konferenca shkencore dhe botime artikujsh Shkencor.</p> <p>GVJ kërkon të njihet nga IAL (Administratori ose NJSBC) se çfarë politika motivuese ka aplikuar UMSH në mbështetjen dhe nxitjen e stafit akademik përveç se ndjek ecurinë e tyre duke bërë vlerësim pikësor në sistemin e vlerësimit të punës së tyre shkencore. Nga IAL pas vizitës na u dërguan evidence shtesë (trajtuar edhe në një kriter më herët në këtë RVJ) ku ilustron rasti i mbështetjes së financimit për veprimtari të cilat shoqërohen edhe me kosto financiare për tarifën e pjesëmarrjes apo publikimit.</p>



	(Tabela 19 në Evidencën 18. "Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit MSCAB". Evidenca shtesë 11.1; 11.2; 11.3.)		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Ka përpjekje të mira të stafit akademik por edhe të UMSH për të motivuar studentët të angazhohen në studime inovative dhe Start-up, kjo realizohet në auditor dhe veçanërisht UMSH është përpjekur përmes grupeve të punës dhe webinaris.  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/133/webinare">https://www.umsh.edu.al/c/133/webinare</a>		
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Bazuar në udhëzimin për përgatitjen e diplomës, për këtë program Studimi janë të përcaktuara gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë, ditët dhe orët në dispozicion ku çdo pedagog i DE që ka student nën udhëheqje të asistojë ata për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomes. Sipas RVB, përgatitja e punimeve të studentëve (tema diplome) realizohet nën kujdesin e pedagogëve sipas specialiteteve dhe kualifikimit, duke mundësuar edhe angazhimin e studentëve në punë kërkimore e shkencore.  (Evidenca 25. Udhëzim për përgatitje diplome; Evidenca 5. Rregullore e programit MScAB me profile)		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X
<b>Standardi V.7</b>			
<b>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Konstatojmë se UMSH është investuar në krijimin e një rrjeti të gjerë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve. Gjithashtu, sipas RVB, UMSH ka hartuar një strategji të zhvillimit të vet për periudhën kohore 2018-2023 që parashtron edhe prioritetet për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Zyra e Projekteve bashkëpunon me një rrjet të gjerë partnerësh në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar duke arritur që UMSH të bëhet lider apo partner në projektet e ndryshme si Erasmus, COST, Horizon 2020, IPA Cross border, CEEPUS; Adrion Interreg. Programi i studimit MSCAB e ka shumë të nevojshme konkretizimin e veprimtarive me këto organizma pasi është një program shkencor studimi ku studentët duhet të kenë mundësi të thellimit të njohurive dhe mobilitetit të tyre edhe me këta partner. Ndërkohë që GVJ konstaton se evidencat (link të veprimtarive) të vendosura për këtë kriter nuk kishin asnjë lidhje me këtë program studimi.		



<p><b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>GVB në këtë kriter nuk ka dhënë argumenta konkrete megjithatë nëse do ti referohemi përsëri të dhënave në tabelën 19 të evidencës 18 “Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit MSCAB” ku konstatojmë se stafi akademik i FSHE ka një pjesëmarrje të konsiderueshme në konferenca shkencore dhe botime artikujsh Shkencor në disa raste edhe me factor impakti dhe të indeksuara. Kjo përbën një referencë të mirë për të pretenduar se ky staf akademik do të sigurojë vijueshmëri në përgatitjen e studentëve për ciklin e tretë të studimeve dhe sidomos për studentët e MSCAB.</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Në kuadrin e shtimit të mobiliteteve ndërmjet UMSH dhe universiteteve nga vende të ndryshme institucioni mirëpret pedagogë dhe kërkuesit shkencorë të huaj në mjediset e tij dhe ju krijon atyre kushte për zhvillimin e aktiviteteve individuale ose të përbashkëta. GVJ, pavarisht se u njoh me disa praktika financimi për mbështetjen e PAE në kërkimin shkencor, përsëri e konsideron të nevojshme të rekomandoj IAL-së se duhet të mbështes më shumë financiarisht PAE-të e rregjistruar në programet e doktoraturës me qëllim thellimin e tyre në studime aplikative në fushën e manaxhimit, si edhe ata studentë të këtij masteri shkencor që mund të kenë mesatare dhe interes për thellimin e kërkimit shkencor.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Në RVB konstatohet se UMSH mirëpret partneritete në projekte të përbashkëta, lektorë të huaj të ftuar për të pasuruar programet mesimore dhe teknikat e mësimdhënies bazuar në strategjinë për zhvillim dhe ndërkombëtarizim të tij. Për këtë kriter GVJ nuk gjeti në RVB asnjë evidencë konkrete në drejtim të zbatimit të strategjisë.</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>GVB në këtë kriter nuk ka dhënë referenca nga kuadri rregullator i UMSH se ku bazohet politika favorizuese e UMSH për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. Gjithashtu, nuk ka evidenca të konkretizuara nëse studentët e programit MScAB kanë qenë pjesëmarrës në aktivitete ndërkombëtare dhe si është mundësuar mobiliteti tyre.</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Në DVV për këtë kriter nuk ka referenca nga kuadri rregullator i UMSH se ku bazohet politika favorizuese e UMSH për të ftuar personel akademik dhe studentë të huaj për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie në UMSH.</p> <p>Gjithashtu, nuk ka evidenca të konkretizuara nëse personel akademik dhe studentë të huaj kanë qenë mësimdhënës apo kërkues shkencor në UMSH.</p> <p>Sipas komunikimit gjatë vizitës në IAL, me drejtues të tij, na u tregua për inisiativat shumë mbresëlënëse në këtë drejtim në UMSH, por ngelet ti vlerësojmë pasi të konkretizohen.</p>		
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht



Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
-------------------------------------	--	--	---	--

**Standardi V.8**  
**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Referuar RVB-së, në përputhje me Udhëzimi nr.27, Dt.29.12. 2017: Pika 6 Shkr b, Pika13, të Ministrisë së Arsimit, UMSH, duke u bazuar edhe në Statutin dhe rregulloren e saj, më qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve, ka ngritur strukturën e karrierës e quajtur Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK). Përsëri, nëse do ti referoheshim GVB, konstatojmë se sipas narrativës së tyre për këtë standard, ZKK mban kontakte të vazhdueshme me studentët e programit MScAB në ecurin e karrierës së tyre profesionale edhe mbas përfundimit të studimeve si edhe i referohet Tabelës 23 “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve” në evidencën 8 “Përmbledhëse e Tabelave për programin MscAB”, e cila në fakt nuk ka asnjë shifër, që do të thotë nuk ka të dhëna për pretendojnë, ndërkohë që studentët e këtij programi studimi janë me disa qindra.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ gjatë vizitës në IAL konstatoi se nuk është e qartë nëse ka një zyrë me staf të dedikuar vetëm për këto detyra apo krahas disa pozicioneve punësh të tjera ju duhet të kryejnë edhe këto detyra të cilat në fakt janë shumë të rëndësishme jo vetëm pse janë detyrim nga kuadri ligjor e rregullator. Por, gjithashtu, u konstata se për udhëzimet e studentëve kujdesej edhe Koordinatorin e programit të studimit, Departamenti, Sekretaria Mesimore, etj.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	(Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu VI, Neni 53; Evidenca 4. Rregullore e UMSH, Kreu IV, Neni 36; Evidenca 30. Rregullore ZKSK; Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB: Tabela 23 “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve”)			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
--	----------------------	----------------------	---------------------	----------------------



				X
--	--	--	--	---

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e depozituar dhe komunikimit me drejtues të IAL gjatë vizitës në IAL, konstatohet se UMSH në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 ka ngritur strukturën e NJSBC dhe Zhvillimit të Karrierës referuar Nenit 53 dhe 84 të Statutit të UMSH dhe nenit 28 të Rregullores së Përgjithshme që nga Janari 2011 në strukturën organizative të institucionit. Gjatë vizitës në IAL dhe takimit me NJSBCZHK.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertët të jashtëm.</p>	<p>Referuar Nenit 52 të Statutit të UMSH dhe Nenit 22 të Rregullores së Përgjithshme mund të ketë të ngritur edhe Komisionin e Përhershëm në funksion të sigurimit të cilësisë, por GVJ nuk arrin të kuptoj përmes RVB e cila në këtë standard nuk ka cituar evidenca dhe bazuar në ato të bënte edhe vlerësimin, por është mjaftuar me komente të përgjithshme. Gjatë vizitës në IAL dhe takimit me NJSBCZHK, nga GVJ u pyet nëse ka Komision të përhershëm për Sigurimin e Cilësisë në UMSH, përgjigja e drejtueses së NJSBCZHK ishte se UMSH nuk e ka këtë komision.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ rekomandon që IAL për shkak të madhësisë që ka si institucion, ka veçse për këtë program studimi janë me disa qindra të regjistruar, duhet të krijojë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë në nivel Institucioni me anëtar nga pretendentët kryesorë, me mandate të qarta dhe raportim në Senatin Akademik të UMSH, si edhe të shikojë mundësinë ta ngrejë edhe në nivel njësie kryesore. Ngritja e këtij komisioni do të shërbej për nxitjen, promovimin dhe monitorimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë në UMSH si edhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë për këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Në funksion të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit Senati Akademik i UMSH ka miratuar Rregulloren e Përgjithshme, Manualin e SBC, Rregulloren e NJSBCZHK, Plani strategjik të zhvillimit të UMSH si edhe</p>



Strategjinë e Zhvillimit të Programit MSCAB të cilat plotësojnë kriteret institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Sipas RVB-së për NJSBCZHK “Ajo përbëhet nga drejtuesi dhe 9 anëtarë të cilët kanë mandat 3-vjeçar dhe 1 studentë”, ndërsa referuar tabelës nr. 24 në evidencën nr. 8, konstatohet se 5 anëtarë përfshirë edhe kryetaren kanë 4 vjet në këtë detyrë. Nga IAL duhet të qartësohet nëse ata janë të punësuar apo të zgjedhur me mandat. Kjo asimetri nuk ndikon pozitivisht në rritjen e cilësisë dhe dobëson rolin e SBC-së.

GVJ rekomandon se IAL duhet të qartësohet pozicionin e anëtarëve në NJSBCZHK nëse ata janë të punësuar apo të zgjedhur me mandat, pasi kjo asimetri nuk ndikon pozitivisht në rritjen e cilësisë dhe dobëson rolin e SBC-së në UMSH. Gjithashtu, IAL duhet të sigurojë përfshirjen e bashkëpunëtorëve e ekspertëve të jashtëm në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.

(Evidenca 1. “Statuti i UMSH” Kreu XI, Neni 53, 84; Evidenca 4. “Rregullore e Organizimit të UMSH” Neni 28, 78, 79; Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK.pdf; Evidenca 12. “Manuali i NJSBCZHK”; Evidenca 8. Përmbledhëse e Tabelave për programin MScAB me profile: Tabela 24)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	UMSH ka integruar në një njësi Zhvillimin e Kurrikulave si edhe SBC duke menduar që këto dy funksione të koordinohen në shërbim të monitorimit, shqyrtimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit të programeve të studimit të ciklit të dytë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Megjithatë sipas RVB-së, në zbatim të akteve rregullative institucionale përsëri pesha bie mbi drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore për të marrë masa organizative dhe monitoruese për procesin mësimor dhe kërkimor, por është anashkaluar evidentimi i përgjegjësive konkrete të NJSBCZHK e cila është Njësia e Posaçme e ngritur nga IAL për të monitoruar, shqyrtuar, mbikëqyrë dhe rishikur programin e studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Në DVV nuk gjenden nga GVJ nëse ka evidenca për të dokumentuar punën e NJSBCZHK për çdo fund viti akademik për proceset e ndryshme të planveprimit edhe raportin përmbledhës të gjithë aktivitetit vjetor si dhe



<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>sygjerimet e kësaj njësie për çdo aktivitet të vlerësuar lidhur me programin e studimit të MScAB.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, ekspertët pyetën përfaqësuesit e NJSBCZHK për:</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>a) Shpeshësinë e raportimit në informimin e drejtuesve të njësive bazë dhe përmes tyre të gjithë stafin mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së stafit akademik.</p> <p>Përgjigja nga NJSBC ishte se përpilohej një raport vjetor, ndërkohë që studentët anketoheshin në përfundim të semestrit para se të bëhet Provimi. Por gjithashtu nga drejtues i NJSBC u bëme me dije se shpeshësia e dhënies së opinionëve të tyre ishte edhe javore pasi ata kontrollonin oraret e hyrje daljes nga klasa të pedagogëve. Kjo ishte një praktikë e pandeshur më parë që NJSBC të merret me këtë element. Gjithashtu, në pyetësor nuk ka pyetje për të vlerësuar cilësinë e punës së stafit administrativ nga studentët, për të cilën sugjerojmë IAL ta marr në konsideratë.</p> <p>Sipas NJSBC, pedagogu njoftohet për rezultatet e arritura dhe nëse ka probleme thërritet nga rektorati. Gjithashtu, "...informacioni i përfutur nga këta instrumenta kontrolli pas përpunimit përdoret në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik nga ana e njësive përgjegjëse para firmosjes së kontratës vjetore". Ky paragraf të lë të kuptosh se gjithë stafi akademik pavarësisht nëse ka grada dhe tituj nuk ka kontratë pune pa-afat por kontrata pune një-vjeçare. GVJ kërkon që IAL ta qartësoj këtë çështje, përndryshe krijon pasiguri tek stafi akademik me grada dhe tituj dhe është në kundërshtim me ligjin.</p> <p>b) Ku gjenden të publikuara dhe çfarë përmban raportet vjetore të NJSBCZHK për 3 vitet e fundit?</p> <p>Evidencat e depozituara në DVV janë më shumë një raportim për strukturat drejtuese se çfarë detyrash ka kryer kjo njësi dhe jo një analizë e gjetjeve dhe adresimi i tyre përgjatë procesit të vlerësimit të cilësisë për programin e studimit ashtu siç e kërkojnë standardet dhe vetë statuti UMSH.</p> <p>c) Çfarë masash janë marr në rast të gjetjes së mospërputhjeve në plotësimin e standardeve të cilësisë sipas manualit? Sipas NJSBC nuk kish qenë e nevojshme të merreshin.</p> <p>Në përfundim, GVJ rekomandon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● NJSBCZHK të mbaj evidenca për të reflektuar ndjekjen e plotësimin të rekomandimeve të dhëna nga raportet e posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</li> <li>● Senati Akademik dhe Bordi Administrimit të UMSH të kërkojnë një analizë (follow up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga raportet për përmirësimin në vijim të cilësisë.</li> </ul>





	<ul style="list-style-type: none"> <li>• IAL të shikojë mundësinë e shtimit të stafit në NJSBCZHK ose të ngarkoj me këtë detyrë vetëm staf administrativ që nuk është i përfshirë edhe në mësimdhënie apo detyra të tjera me qëllim për të ushtruar veprimtarinë e njësisë sipas standardeve të kërkuara.</li> </ul> <p>(Evidenca 1. Statuti i UMSH, Neni 53, 84. Evidenca 12. Manuali i NJSBCZHK, neni 4; Evidenca 19. Plan pune për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021; Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut nga Autoriteti Drejtues.)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>UMSH ka përgjegjësinë t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve mësimore, të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase tarifat e studimit nga studentët e tij, etj., dhe të sigurojë mbarëvajtjen cilësore të këtij programi studimi jo vetëm deri në diplomimin e studentëve por edhe daljen e tyre në tregun e punës apo sigurimin e trajnimit të vijueshëm të tyre edhe pas diplomimit.</p> <p>Sipas RVB-së, NJSBCZHK raporton tregues, opinione dhe sugjerime që vijnë nga vlerësimi i pedagogut dhe lëndës përmes pyetësorëve, sondazheve, e fokus grupeve të studentëve të të gjitha viteve dhe programeve dhe kontakteve të vazhdueshme me ata. Lidhur me këto sa më sipër GVJ nuk ka gjetur në DVV evidenca të këtyre eksperiencave/praktikave të aplikuara në UMSH për të vërtetuar ato çfarë janë shkruar nga GVB. Rol të vecantë luan edhe vlerësimi për programet e studimit nga palë të treta të fushës përkatëse nga sektori publik dhe privat.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Por, GVJ nuk konstatoi në raport të kryhen sondazhe apo intervista me aktorë të tregut të punës për punësimin e studentëve të këtij programi pavarësisht se edhe sipas manualit të NJSBCZHK i jepet rol i vecantë vlerësimit të programit të studimit nga palë të treta të fushës përkatëse (nga sektori publik dhe privat).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ i këshillon IAL-së që përveç metodave që ai aplikon duhet të përdorë edhe metoda dhe instrumenta të tjera të cilat ndihmojnë vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit, të tilla si</p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>sondazhe e intervista me punëdhënës për studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Evidenca 20. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut nga Autoriteti Drejtues; Evidenca 22. Procedura e punës me focus grupet; Evidenca 12. Manuali i NJSBCZHK, neni 4.)</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB nuk shprehet qartë lidhur me këtë standard, por referuar Evidencave të depozituara në AMS mund të evidentojmë se Senati Akademik i UMSH është siguruar që përmes miratimit të Manualit të SBC dhe Rregullores së Përgjithshme të përfshijë aktorë të brendshëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit përmes citimit në nenin 4 dhe 5 të Manualit të SBC ku përcaktohet ngritja e GVB dhe në përbërje të tyre të ketë përfaqësues të studentëve, stafit akademik dhe atij ndihmësakademik apo administrativë.</p> <p>GVJ në Manualin e SBC konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Në nenin 2 të tij është përcaktuar përbërja e NJSBC e cila nuk ka asnjë përfaqësim nga aktorë të jashtëm të interesuar të tillë si punëdhënës apo ekspertë të jashtëm të fushës, etj.</li> <li>● Në nenin 6 të tij është përcaktuar cikli i Vetëvlerësimit të Brendshëm të Cilësisë si rregull një herë në 6 vjet duke ju referuar edhe ligjit të arsimit të lartë, dhe vetëm vlerësime të pjesëshme edhe më shpesh nëse do të jetë e nevojshme. Kjo bie ndesh me frymën e ligjit dhe standardet e monitorimit të cilësisë të cilat janë në përfaqje të metodologjisë me bazë</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë</p>	



<p>çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>riskun dhe jo me cikël. Në nenin 106 të ligjit të arsimit të lartë citohe: “Vlefshmëria e çdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet”, duke shprehur një tavan të sipërm për numrin e viteve maksimale të mundëshme për akreditim nga bordi i ASCAL por aspak për t’u aplikuar kjo si tregues nga strukturat brenda IAL të cilat kanë detyrë dhe përgjegjësi për vlerësimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se nuk ka evidenca (dokumenta) që tregojnë përfshirjen më të gjerë të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizë të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj dhe çfarë janë reflektuar në realitet nëse ka pasë të tilla takime.</p> <p><i>(Ligji i Arsimit të Lartë (80-2015 i datës 22.07.2015); Evidenca 1 Statuti i UMSH.pdf; Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH.pdf; Evidenca 12. Manuali i NJSBCZHK ;)</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton se në këtë standard ashtu si edhe në disa të tjera të kësaj fushe vlerësimi në RVB nuk janë dhënë përgjigje për atë çfarë kërkojnë kriteret por ka përsëritje të përgjigjeve, si edhe ka mungesë të referencave dhe evidencave. Të gjitha sa më sipër e vendosin në vështirësi vlerësimin nga ana e GVJ-së.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Sipas statutit dhe Rregullores së përgjithshme të UMSH nuk ishte e qartë nëse ishte detyrim ekzistenca e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë së Institucionit, si organ përgjegjës para Senatit për sigurimin e cilësisë në këtë IAL. Nga GVJ sipas përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarit u konstatua se nuk ekziston ky komision në nivel Institucional. Megjithatë sipas NJSBC u saktësua se UMSH nuk e ka këtë lloj komisioni.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar ne RVB, UMSH për gatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e</p>	<p>Bazuar ne RVB, UMSH për gatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion</p>



<p>vlerësimin të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>pretendentëve (drejtues, pedagogë, të tjerë të interesuar). Tërheqja e mendimit të studentëve në UMSH ka shërbyer për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së pedagogëve dhe sipas GVB në ndonjë rast ka pasë edhe marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndërsa NJSBC nuk na konfirmoi ndonjë gjetje materiale të marrë nga studentët dhe si rrjedhim nuk ka pasë asnjë masë të marrë. Kjo për GVJ do të thotë se ka paqartësi edhe brenda vetë IAL-së lidhur me punën e NJSBC. Sipas RVB konstatohen disa rast/gjetje të konsideruara si problemet më kryesore të cilat kanë qënë të lidhura me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimin, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj. Si edhe për ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve në UMSH është arritur përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi.</p> <p>Një tjetër kërkesë e një kriteri në këtë standard është për publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit. GVJ gjatë vlerësimit të RVB, website të IAL-së, si edhe evidencave të depozituara në AMS nuk konstaton që IAL të ketë plotësuar kërkesën e këtij kriteri duke siguruar transparencë për publikimin edhe në faqen web të UMSH të Raporteve për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve. Në këtë mënyrë nuk sigurohet transparenca për studentët dhe të gjithë palët e interesuara.</p> <p>Në përfundim, GVJ i sugjeron IAL-së, të merren masat për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Publikim të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit “Master Shkencor në Administrim Biznesi” me profile, të Institucionit të Arsimit të Lartë, “UMSH”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Në këtë program studimi ka disa titullarë lëndësh me kualitet të lartë akademik dhe aplikativ.
2. Ka rishikimet e nevojshme të disa prej syllabulls për ti përafuar ato me realitetin dhe zhvillimet në administrimin e biznesit në Shqipëri.
3. Ka prezencë të evidentuar mediatikisht në forume, konferenca dhe takime të cilat ju mundësojnë stafit akademik të këtij programi të kenë kontakte, të marrin përgjigje apo shkëmbejnë ide me ekspertë të fushës vendas apo të huaj.
4. Vendodhja e UMSH është një pikë e fortë për shkak të afërsisë me institucionet kryesore në vend dhe mbulohet lehtësisht nga transporti publik.
5. Shumë aktiv në lidhjen e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve konkrete me IAL të tjera homologe brenda dhe jashtë vendit.

**Pika të dobta:**

1. Personeli akademik kryen edhe detyra administrative, kjo mund të pengojë këta të fundit në përmbushjen e detyrimeve të tyre ndaj procesit mësimor e kërkimit shkencor. **Standardi IV.2**
2. IAL nuk ka adresuar ende rekomandimin e dhënë nga Bordi ASCAL gjatë akreditimit institucional ku UMSH i kërkohet të zgjeroj ambjentet për zhvillimin e programeve studimore, ku pjesë e tyre është edhe programi studimit MscAB i cili ka mbi 400 student aktivë (viti i parë dhe i dytë). **Standardi IV.3**
3. Hapësira e ofruar nga biblioteka është relativisht e limituar. **Standardi IV.4**
4. Mungesë të mbështetjes financiare për kërkim shkencor të studentëve të këtij programi studimi të cilët mund të kenë interes për thellimin e kërkimit të tyre shkencor. **Standardi V.7**
5. GVJ evidenton se në UMSH nuk ka një njësi më vete në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore (Zakonisht ato quhen Zyra/Njësia për Këshillimin e Karrierës). **Standardi V.8**
6. Nuk ka mundësuar ende përfshirjen e studentëve, alumni, punëdhënës apo ekspertë të jashtëm të fushës, etj, në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. **Standardi VI.1**
7. Nuk ka evidencë që IAL të ketë siguruar transparencë për publikimin në faqen web të UMSH të Raporteve për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve. **Standardi VI.5**




### **Rekomandime:**

1. Ndarja e ngarkesës akademike dhe asaj administrative.
2. Sugjerohet hartimi i një plani të detajuar vjetor për pasurimin e titujve në bibliotekë.
3. Institucioni duhet të hartojë një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe një plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.
4. IAL ti japë pozicionin e duhur Zyrës së Karrierës duke e krijuar si strukturë më vete të shkëputur nga NJSBC me qëllim ndjekjen efektive të ecurisë së ALUMNI dhe tërheqjen e mendimeve të tyre në mënyrë të vazhdueshme.
5. IAL të shikojë mundësinë e shtimit të stafit në NJSBC, si edhe duhet të sigurohet që NJSBC përfshin përfaqësime nga studentë, alumni, bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm të fushës në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.
6. Senati Akademik dhe Bordi Administrimit të UMSH të kërkojnë një analizë (follow up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga raportet për përmirësimin në vijim të cilësisë.
7. IAL të kujdeset për publikim të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.
8. IAL të marrë menjëherë masat për plotësimin e rekomandimit të Bordit të ASCAL për zgjerimin e ambjenteve në funksion të programeve të studimit të hapura dhe akredituara pranë UMSH.

### **Conclusions of the Evaluation of the study program "Master of Science in Business Administration" with profiles, of the Institution of Higher Education, "UMSH"**

#### **Strengths and Affirmations:**

1. In this study program there are several academic staff with high academic and applied qualitative experiences.
2. There are necessary revisions of some of the syllabuses to align them with reality and developments in the business administration in Albania.
3. There is media evidenced presence in forums, conferences and meetings which enable the academic staff of this program to have contacts, receive answers or exchange ideas with local or foreign experts in the field.
4. The location of UMSH is a strong point due to its closeness to the main public institutions in the country and is easily covered by public transport.
5. Very active in signing agreements and collaborations with other homologous HEIs inside and outside the country.





**Weak points:**

1. Academic personnel perform administrative tasks as well. This may prevent them from fulfilling their obligations towards the teaching process and scientific research. **Standard IV.2**
2. HEI has not yet addressed the recommendation given by the ASCAL Board during the institutional accreditation where UMSH is asked to expand the facilities for the development of study programs, where part of them is the MSc, BA study program which has over 400 active students (first year and second). **Standard IV.3**
3. The space offered by the library is relatively limited. **Standard IV.4**
4. Lack of financial support for scientific research of students of this program who might have interest in deepening scientific research. **Standard V.7**
5. EEG notes that in UMSH there is no separate unit in the service of information for students in accordance with the legal provisions (Usually they are called Office/Unit for Career Counseling). **Standard V.8**
6. HEI has not yet enabled the inclusion of students, alumni, employers or external experts of this field, in the Internal Quality Assurance System. **Standard VI.1**
7. There is no evidence that the HEI has ensured transparency for the publication on the UMSH website of the Reports for the analysis of the results of the questionnaires from the student surveys. **Standard VI.5**

**Recommendations:**

1. Separation of academic and administrative workload.
2. It is suggested to draw up a detailed annual plan for the enrichment of titles in the library.
3. The institution must draw up a financial report of the costs of the study program and a plan for the financial support necessary for the smooth running of the study program for at least one full study cycle.
4. To give the right position to the Career Office by creating it as a separate structure separated from IQAU in order to effectively follow the progress of ALUMNI and draw their opinions continuously.
5. To look at the possibility of increasing the staff in the IQAU, as well as to ensure that the IQAU includes representatives from students, alumni, collaborators and external experts of the field in the Internal Quality Assurance System.
6. The Academic Senate and the Administrative Board of UMSH to request an analysis (follow up) of the implementation of tasks or measures to address the findings, deficiencies and recommendations evidenced by the reports for further quality improvement.
7. The HEI should take care of publishing the results of the evaluations of the study program, respecting academic freedom and ethics, as well as the legislation on personal data.
8. The HEI should immediately take measures to fulfill the recommendation of the ASCAL Board for the expansion of the facilities in function of the study programs opened and accredited at the UMSH.



## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

